

Raporti në Hije për Kapitullin 27

2023

P L A T F O R M A 2 7



27

CIP - Каталогизacija во публикаcija
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент
Охридски", Скопје

502/504:340.137(497:4-672EY)"2023"(047)
551.583:340.137(497:4-672EY)"2023"(047)
502/504:340.132(497:7)"2023"(047)
551.583:340.132(497:7)"2023"(047)

RAPORT në hije për Kapitullin 27-2023 [Електронски извор]
/ [autorë Filip Stojanovski ... [и др.] ; përkthimi në shqip nga
maqedonishtja Rexhep Xheladini]. - Shkup : Shoqata e
juristëve të rinj të Maqedonisë, 2024

Начин на пристапување (URL):
<https://myla.org.mk/wp-content/uploads/2024/05/%D0%98%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98-%D0%B2%D0%BE-%D0%A1%D0%B5%D0%BD%D0%BA%D0%B0-ALB.pdf>
- Превод на делото: Извештај во сенка за Поглавје
27-2023 година. - Текст во ПДФ формат, содржи 81
стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на
изворот на ден 21.05.2024. - Фусноти кон текстот. -
Други автори: Bojana Stanojevska Pecurovska, Daniela
Mladenovska, Aleksandra Karakashova Saçkarska, Petra
Pop Ristova, Robertina Brajanoska, Metodija Velevski, Danka
Uzunova, Arta Starova. - Organizatat civile në veprim për
ndryshimet klimatike

ISBN 978-608-4843-91-7

1. Stojanovski, Filip [автор] 2. Stanojevska Pecurovska,
Bojana [автор] 3. Mladenovska, Daniela [автор] 4.
Karakashova Saçkarska, Aleksandra [автор] 5. Pop Ristova,
Petra [автор] 6. Brajanoska, Robertina [автор] 7. Velevski,
Metodija [автор] 8. Uzunova, Danka [автор] 9. Starova,
Arta [автор] 10. Nikolovska, Elena [автор] а) Животна
средина и климатски промени -- Законодавство --
Македонија -- Усогласеност со ЕУ -- 2023 -- Извештаи б)
Животна средина и климатски промени -- Законодавство
-- Македонија -- 2023 -- Извештаи

COBISS.MK-ID 63751173



Ky dokument/publikim është financuar nga Suedia.
Suedia nuk ndan domosdoshmërisht pikëpamjet e
shprehura në këtë material. Përgjegjësia për përmbajtjen
e tij i takon tërësisht autorit.

Titulli

Raport në Hijе për Kapitullin 27 - 2023

Titulli origjinal

Извештај во сенка за Поглавје 27 - 2023 година

Botues

Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë

Projekti

Organizatat civile në veprim për ndryshimet klimatike

Zbatues

Projekti zbatohet nga Qendra për hulumtim dhe informim për mje-
disin jetësor "Eko-svest" nga Shkupi, Shoqata e Juristëve të Rinj të
Maqedonisë (SHJRM) dhe Organizata Lidhja e Vlerave Natyrore
dhe Njerëzve-CNVP

Autorë

Cilësia e ajrit

Filip Stojanovski

Qendra për Ndryshimet Klimatike

Menaxhimi i mbetjeve

Mr. Bojana Stanojevska Pecurovska

Qendra për Ndryshimet Klimatike

Ndotja industriale dhe menaxhimi i rrezikut

Dr. Daniela Mladenovska

Qendra për Ndryshimet Klimatike

Legjislacioni horizontal

Aleksandra Karakashova Saçkarska

ZOR "Milieukontakt Maqedoni"

Cilësia e ujërave

Dr. Petra Pop Ristova

ZOR "Milieukontakt" Maqedoni

Mbrojtja e natyrës

Mr. Robertina Brajanoska, Dr. Metodija Velevski,

Danka Uzunova, Arta Starova

Shoqata Ekologjike e Maqedonisë - Shkup

Ndryshimet klimatike

Elena Nikolovska, Eko-Svest - Shkup

Redaktore

Bojana Bozhinovska Siljanovska, SHJRM - Shkup



Redaktimi gjuhësor në maqedonisht

Eleonora Stojkoska – Popetrevska

Përkthimi në shqip nga maqedonishtja

Rexhep Xheladini

Dizajni grafik

Haris Muriq

Shkup, 2024

1	1	HYRJE
1		1.1 Platforma 27
2	2	LEGJISLACIONI HORIZONTAL
3		2.1 Pasqyrë për progresin në nënkapitullin gjatë vitit 2023
5		2.2 Zbatimi i legjislacionit
10		2.3 Rekomandime për përmirësim
17	3	AJRI
18		3.1 Pasqyrë për progresin në nënkapitullin gjatë vitit 2023
18		3.2 Zbatimi i legjislacionit
26		3.3 Rekomandime për përmirësim
29	4	UJËRAT
30		4.1 Pasqyrë për progresin në nënkapitullin gjatë vitit 2023
31		4.2 Zbatimi i legjislacionit
31		4.2.1 Zbatimi i Direktivës Kornizë të Ujërave
32		4.2.2 Zbatimi i Direktivës së BE-së për Ujërat e Zeza Urbane
35		4.2.3 Zbatimi i Direktivës së BE-së për ujin e pijshëm
38		4.2.4 Zbatimi i Direktivës së BE-së për ujërat nëntokësorë
38		4.3 Rekomandime për përmirësim
40	5	MENAXHIMI I MBETJEVE
41		5.1 Pasqyrë për progresin në nënkapitullin gjatë vitit 2023
42		5.2 Zbatimi i legjislacionit
46		5.3 Rekomandime për përmirësim
47	6	NDOTJA INDUSTRIALE DHE MENAXHIMI I RREZIKUT
48		6.1 Pasqyrë për progresin në nënkapitullin gjatë vitit 2023
49		6.2 Zbatimi i legjislacionit
49		6.2.1 Kapacitetet teknike dhe administrative në nivel qendror dhe lokal
50		6.2.2 Bashkëpunimi me operatorët dhe bashkëpunimi në nivel qendror – lokal
50		6.2.3 Transparenca në fushën e lejeve të lëshuara, procesin e dhënies së lejeve dhe burimeve financiare
51		6.2.4 Metodologjia për shkrimin e lejeve A dhe B
52		6.3 Rekomandime për përmirësim
53	7	NATYRA
54		7.1 Pasqyrë për progresin në nënkapitullin gjatë vitit 2023
56		7.2 Zbatimi i legjislacionit
60		7.3 Rekomandime për përmirësim
65	8	NDRYSHIMET KLIMATIKE
66		8.1 Pasqyrë për progresin në nënkapitullin 2023
67		8.2 Zbatimi i legjislacionit
72		8.3 Rekomandime për përmirësim
74	9	FINANCIMI
80		9.1 Kapacitetet administrative

1 Hyrje

1.1 Platforma 27

Platforma 27 është rrjet joformal i përbërë nga më shumë se 20 organizata që punojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike që u krijua në vitin 2020. Raporti është përgatitur në bazë të metodologjisë së zhvilluar paraprakisht me të cilën katër organizata (Qendra për Ndryshime Klimatike, Eko-Svest, Milieukontakt Maqedoni dhe Shoqata Ekologjike e Maqedonisë punojnë në monitorimin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me legjislacionin evropian, por edhe në zbatimin e legjislacionit në nivel kombëtar dhe vendor, analizojnë progresin dhe bëjnë përmbledhje të gjetjeve kryesore në një raport të titulluar Raporti në Hijë për Kapitullin 27.

Ky raport mbulon vetëm nënkapitujt: "legjislacioni horizontal", "cilësia e ujërave", "menaxhimi i mbetjeve", "cilësia e ajrit të ambientit", "ndotja industriale dhe menaxhimi i rrezikut", "mbrojtja e natyrës" dhe "ndryshimet klimatike", gjegjësisht ato sektor ku ka progres dhe që përfshijnë disa direktiva. Në Raportin në hijë për Kapitullin 27 për vitin 2023, kemi analizuar progresin në vitin e fundit, pra në periudhën nga dhjetori 2022 deri në dhjetor 2023 dhe përgatitja është mundësuar nga projekti "Organizatrat Civile në Veprim për Ndryshimet Klimatike" i implementuar nga "Eko-Svest", SHJRM dhe CNVP dhe financuar nga Qeveria e Suedisë.

Qëllimi i këtij Raporti është të japë një pasqyrë të detajuar të progresit në harmonizimin e legjislacionit kombëtar me atë evropian për këta sektorë që janë pjesë e Kapitullit 27, mjedisi jetësor dhe ndryshimet klimatike, por edhe të analizojë zbatimin në nivel kombëtar dhe lokal. Raporti identifikon mangësitë në këto procese, i vë në dukje, si dhe analizon zbatimin e rekomandimeve dhe mënyrat për tejkalimin e tyre. Në të njëjtën kohë, ky raport duhet të përmirësojë dialogun ndërmjet institucioneve përkatëse, sektorit civil, publikut profesional, komunitetit ndërkombëtar dhe të gjithë aktorëve në procesin e harmonizimit të legjislacionit dhe zbatimit të tij, por edhe të sigurojë vazhdimësi në bashkëpunimin ndërmjet palëve përkatëse të interesit. Është shumë e rëndësishme që raporti është punuar nga 4 organizata që kanë më shumë se 10 vjet përvojë në fushën e mjedisit jetësor dhe që monitorojnë vazhdimisht situatën në vend në fushën e mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike.

2

Legjislacioni Horizontal



2 Legjislacioni Horizontal

2.1 Pasqyrë për progresin në nënkapitullin gjatë vitit 2023

Raporti i fundit i Komisionit Evropian (08.11.2023) për progresin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nuk shënon progres të rëndësishëm për nënkapitullin – legjislacioni horizontal:

“Për sa i përket legjislacionit horizontal, Maqedonia e Veriut duhet të intensifikojë punën për të arritur harmonizimin e plotë me vlerësimin e ndikimit në mjedis jetësor dhe për evaluimin e vlerësimeve strategjike për mjedisin jetësor, të cilat janë gurë themeli. Kjo ka një ndikim negativ në të gjithë sektorët e tjerë të mjedisit jetësor, në investimet në infrastrukturë dhe në pjesëmarrjen dhe perceptimin e përgjithshëm të publikut. Në korrik 2022, Ligji për Mjedisin Jetësor u plotësua për të futur një ndalim për ndërtimin/ rindërtimin e instalimeve të reja për industrinë e rënda dhe ndotëse brenda një rrezeje më të vogël se pesë kilometra nga një vendbanim ose një zonë e mbrojtur natyrore. Vendi ende nuk është harmonizuar me Direktivën e Përgjegjësisë Mjedisore dhe Direktivën për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor përmes së drejtës penale. Mungesa e stafit të specializuar dhe kapacitetet e dobëta institucionale dhe administrative dëmtojnë kontrollin e cilësisë dhe performancën e vlerësimeve të ndikimit në mjedisin jetësor.”

Direktiva 2007/2/EC INSPIRE - Përfaqësimi i të dhënave hapësinore për mjedisin jetësor synon të krijojë një infrastrukturë të të dhënave hapësinore të Bashkimit Evropian (BE), për të mundësuar shkëmbimin e informacionit hapësinor për mjedisin jetësor ndërmjet organizatave të sektorit publik dhe qasje më të lehtë të publikut në të dhënat hapësinore; si dhe 2001/331/EC RMCEI – Standardet minimale për zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese që përcaktojnë udhëzime për inspektimet në mjedisin jetësor të instalimeve, impianteve dhe stabilimenteve të tjera që lëshojnë emetime në ajër, ujë ose kryejnë aktivitete të depozitimit ose rikuperimit të mbetjeve dhe që i nënshtrohen kërkesave për autorizim, leje ose licencim ("instalime të kontrolluara") nuk janë shënuar fare në Raportin e fundit të Komisionit Evropian.

Programi kombëtar për miratimin e së drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA) për periudhën nga 2021-2025, për sa i përket legjislacionit horizontal do të angazhohet për harmonizimin me legjislacionin e BE-së të prezantuar në Mbledhjen Shpjeguese 2019, pra do të miratohen aktet e mëposhtme: Ligji për Mjedisin Jetësor, Ligji për Inspektimin në Mjedis Jetësor, si dhe Kodi i ri Penal me përforsim të dispozitave në pjesën e sanksionimit të shkeljeve të mjedisit jetësor.

Propozim Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mjedisin jetësor (i përgatitur në nëntor 2020 dhe i miratuar në vitin 2022) kishte për qëllim, ndër të tjera, harmonizimin e statusit të ekspertëve për vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor të projektit dhe ekspertit për vlerësim strategjik në mjedisin jetësor. Në përputhje me këto ndryshime, personat fizikë që posedojnë certifikatën e dhënies së provimit profesional për fitimin e statusit të ekspertit në vlerësimin strategjik në mjedisin jetësor, vërtetimin e dhënies së provimit profesional për marrjen e njohurive profesionale për vlerësimin strategjik në mjedisin jetësor, brenda katër muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet t'i paraqesë një kërkesë organit të administratës shtetërore përgjegjëse për kryerjen e punëve në fushën e mjedisit jetësor për lëshimin e vërtetimit për dhënien e provimit profesional për fitimin e statusit të ekspertit për vlerësimin e ndikimit të projekteve në mjedisin jetësor, pra ekspert për vlerësimin strategjik të mjedisit jetësor.

Me miratimin e ndryshimeve lidhur me dhënien e provimeve profesionale për sa i përket vlefshmërisë së certifikatave për dhënien e provimit profesional për fitimin e statusit të ekspertit në vlerësimin e ndikimit të projektit në mjedis jetësor dhe vlerësimin strategjik të mjedisit jetësor i fituar sipas mënyrës së vjetër të dhënies së provimit, do të mundësohet harmonizimi i statusit të tyre me ata që e kanë dhënë provimin pas futjes së metodës së re të dhënies së provimit. Me ndryshimin do të mundësohet që të gjithë ata që kanë kaluar provimin të fitojnë status të barabartë dhe të jenë pjesë e listës së ekspertëve.

Këto ndryshime nuk parashikojnë harmonizimin dhe përshtatjen e procedurave për vlerësimin e valorizimit të ndikimit në mjedis dhe vlerësimin strategjik të ndikimit në mjedisin jetësor me një analizë të zbatimit të tyre dhe një zbatim më të mirë të procesit të konsultimeve publike, të cilat janë kërkesa të Direktivave VNM-së dhe VSM-së.

Me asistencë teknike nga Komuniteti Energjetik, është përgatitur draft versioni i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Mjedisin Jetësor, me qëllim të harmonizimit dhe transpozimit të Direktivës 2014/52/BE në Ligjin për Mjedisin Jetësor (Kapitulli XI - Vlerësimi i ndikimeve të projekteve të caktuara në mjedisin jetësor). Propozohen ndryshime dhe plotësime në procedurën e vlerëimit të ndikimit në mjedis jetësor, në çdo hap të procedurës, në njoftime, në përcaktimin e fushëveprimit, vlerësimin e duhur etj. Draft-teksti i Ligjit është në proces të harmonizimit të brendshëm në MMJPH-jë dhe ende nuk është publikuar në ENER. Sipas NPAA, pritet të miratohet deri në fund të vitit 2022, por ky afat është tejkaluar. IPA Projekti – "Mbështetje për zbatimin e legjislacionit horizontal" (pritet të fillojë në vitin 2024), parashikon aktivitete për analizën e legjislacionit në nivel kombëtar që rregullon procedurën për vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor dhe procedurën për vlerësimin strategjik të ndikimit në mjedisin jetësor me një analizë të zbatimit të tyre, si dhe një zbatim më të mirë të procesit të konsultimit publik. Në kuadër të projektit do të hartohet një projektligj i ri për mjedisin jetësor, në të cilin do të transpozohen direktivat nga legjislacioni horizontal.

Direktiva për qasje në informacionin për mjedisin jetësor dhe Direktiva për pjesëmarrjen e publikut në vendimarrjen për mjedisin jetësor, janë transpozuar plotësisht në Ligjin aktual të Mjedisit Jetësor dhe aktet nënligjore përkatëse.

RMCEI – Standardet minimale për zbatimin e inspektimit në mjedisin jetësor, janë të inkuorporuara në Ligjin për Inspektim në Mjedisin jetësor (LIMJ), miratuar në vitin 2022 dhe në përputhje me të duhet të hartohet Strategjia kombëtare për mbikëqyrje inspektuese në mjedisin jetësor (brenda 6 viteve nga miratimi i ligjit) dhe Programi për mbikëqyrje inspektuese në mjedisin jetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (brenda 3 viteve nga miratimi i ligjit).

Sipas NPAA, parashihet miratimi i Planit Kombëtar për Inspektimin në Mjedisin Jetësor, i cili do të zhvillohet pas miratimit të Ligjit për Inspektimin në Mjedisin Jetësor, me të cilin do të bëhet planifikimi shumëvjeçar i inspektimit në mjedisin jetësor. Ky plan është ende në fazën përgatitore dhe nuk është miratuar.

Direktiva për përgjegjësinë për dëmet e shkaktuara në mjedisin jetësor, nuk shënon miratim dhe zbatim të vendimeve ligjore në vitin 2023.

Direktiva INSPIRE – Prezantimi i të dhënave të hapësirës për mjedisin jetësor

Është miratuar Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për infrastrukturën kombëtare të të dhënave hapësimore (IKDHH) të Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 129, datë 21.6.2023), i cili parasheh sublimimin e temave të grumbullimit të të dhënave hapësimore në Regjistrin e koleksioneve të të dhënave hapësimore, i cili duhet të krijohet brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Subjektet në IKDHH-së që krijojnë, pra të dhëna hapësimore të tyre, janë të detyruar të krijojnë, mirëmbajnë dhe përditësojnë meta të dhënat për koleksionet e të dhënave dhe shërbimeve hapësimore.

Sipas ndryshimeve të fundit, subjektet në IKDHH-ë janë të detyruar që brenda dy viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji të digjitalizojnë të dhënat gjeohapësimore dhe brenda tre viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji janë të detyruar të ofrojnë shërbimet për shkëmbimin e të dhënave gjeohapësimore.

Subjektet në IKDHH duhet të respektojnë plotësisht dispozitat e këtij ligji më së voni deri më 31 dhjetor 2024.

Direktiva për krimin në mjedisin jetësor, gjatë muajit shtator 2023 u miratuan ndryshimet në Kodin Penal, gjegjësisht është rishikuar Kreu 25, i cili i referohet veprave penale kundër mjedisit jetësor dhe natyrës, u rishikua dhe u plotësua me nene të reja, si p.sh. “ekocidi”, i cili parashikon një dënim nga 10 vjet deri në burgim të përjetshëm, në varësi të dëmit të shkaktuar.

Kapacitetet e pamjaftueshme të Sekretariatit për legjislacion dhe joefikasiteti i procedurës legjislative në Kuvend kontribuojnë në transpozimin e parakohshëm të ligjeve dhe akteve nënligjore me legjislacionin e BE-së.

2.2 Zbatimi i legjislacionit

- ↘ **2011/92/EU EIA – Environmental Impact Assessment - Direktiva për vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor (VNM)**
- ↘ **2001/42/EC SEA – Strategic Environmental Assessment - Direktiva për vlerësimin strategjik të ndikimit në mjedisin jetësor (VSNM).**

Për sa i përket zbatimit të Direktivës VNM, gjetjet janë identike si në vitet e mëparshme, pra në dy raportet e mëparshme në hije (2021 dhe 2022).

Procedurat në përgjithësi zbatohen, por pavarësisht nga indikacionet në raportet e mëparshme, çështjet e informimit në kohë dhe përfshirjes së publikut të interesuar në fazën më të hershme janë ende të hapura dhe aktuale (njoftimet për synimin për të zbatuar projektet nuk janë publikuar në faqen kryesore të MMJPH-së dhe nuk specifikohet data se kur janë publikuar), gjë që e bën të pamundur pjesëmarrjen e publikut në procedurë siç është përcaktuar.

Kundër kësaj, neni 2 i Rregullores për përmbajtjen e publikimit të njoftimit të qëllimit për të zbatuar një projekt, të vendimit për nevojën e vlerësimit të ndikimit të projektit në mjedis jetësor, studimi i vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor të projektit, raporti mbi përshtatshmërinë e studimit të vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor dhe vendimi që jep pëlqimin ose refuzimin e zbatimit të projektit, si dhe mënyrën e konsultimit publik, përcakton se çfarë informacioni duhet të përmbajë publikimi i njoftimit të synimit për të zbatuar një projekt (emri dhe mbiemri, adresa dhe informacioni i kontaktit të aplikantit; qëllimi i projektit dhe përshkrimi i shkurtër i projektit; përshkrimin e aktiviteteve të planifikuara me projektin; vendndodhjen e projektit duke përfshirë adresën dhe numrin në një ngastër toke; duke treguar se kërkesa është në dispozicion në ueb-faqen e MMJPH-së dhe duke treguar vendin dhe periudhën gjatë së cilës publiku mund ta shqyrtojë atë; mënyrën dhe procedurën përmes së cilës publiku mund të paraqesë mendime/komente; kush është autoriteti kompetent për marrjen e vendimit dhe ku mund të merren informacione shtesë për projektin).

Neni 81 i Ligjit aktual të Mjedisit Jetësor përcakton procedurën për përcaktimin e nevojës për një vlerësim të ndikimit të projektit në mjedisin jetësor. Njoftimi i qëllimit për të zbatuar një projekt dhe kërkesa për të përcaktuar nevojën për një vlerësim të ndikimit të projektit në mjedis jetësor (gjegjesisht lista kontrolluese për përcaktimin e nevojës për një vlerësim të ndikimit të projektit në mjedisin jetësor), zakonisht dorëzohen së bashku në MMJPH-jë. Organi i administratës shtetërore përgjegjës për çështjet e mjedisit jetësor, njofton investitorin me vendim për nevojën dhe shtrirjen e vlerësimit të ndikimit të projektit në mjedisin jetësor. Ky vendim duhet të publikohet në ueb-faqen dhe të jetë në dispozicion për publikun, por jo gjithmonë publikohet.

Sa i përket zbatimit të Direktivës VSM, sërish gjetjet janë identike si në vitet e mëparshme, pra në dy raportet e mëparshme në hije (2021 dhe 2022).

Neni 65 (Vlerësimi Strategjik) i LMJ-së aktual thotë se autoriteti që përgatit dokumentin e planifikimit është i detyruar të marrë një vendim për të zbatuar ose një vendim për (mos)zbatimin e një vlerësimi strategjik në të cilin arsyet e zbatimit, gjegjesisht moszbatimi i Procedurës së VSM-së, janë shpjeguar. Vendimin e merr personi përgjegjës i organit që përgatit dokumentin planor, gjegjesisht kryetari i komunës, kryetari i qytetit të Shkupit ose ministri i organit që përgatit dokumentin planor dhe ai vendim duhet të publikohet në ueb-faqen e autoritetit që përgatit dokumentin e planifikimit brenda 15 ditëve. Vendimi i përcillet MMJPH-së, për të cilën Ministria jep një mendim, i cili duhet të bëhet edhe publik. Draft Raporti i VSM-së duhet të jetë në dispozicion për publikun (i publikuar në ueb-faqe) brenda 30 ditëve së bashku me dokumentin e planifikimit.

Zbatimi i procedurës shpesh është i paplotë. Kjo do të thotë se vendimi për zbatimin ose mos(zbatimin) e VSM-së ose publikohet së bashku me mendimin e MMJPH-së. Draft-raporti publikohet pa informacion për një shpallje të përcaktuar saktësisht, ose në të kundërtën shpallet njoftimi një ose dy ditë para mbajtjes së seancës publike. Draft raporti i VSM-së nuk publikohet gjithmonë së bashku me dokumentin e planifikimit. Afati i fundit për inspektimin dhe dorëzimin e komenteve nuk është gjithmonë 30 ditë. Një numër shumë i vogël i autoriteteve që përgatisin dokumentin e planifikimit dhe janë përgjegjës për zbatimin e procedurës së VSM-së publikojnë një raport të konsultimit publik.

Për sa i përket zbatimit të Konventës së Aarhusit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (Direktiva për qasje në informacione për mjedisin jetësor dhe Direktiva për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen

për mjedisin jetësor), mund të thuhet se ka progres në lidhje me aktualizimin e dispozitave të shtyllës së parë dhe të dytë të Konventës nga Qendra Aarhus, përkatësisht realizimi i trajnimeve për përfaqësues të vetëqeverisjes lokale, shoqata të qytetarëve, organizata rinore në mënyrë të pavarur ose përmes projekteve të cilat mbështeten nga Misioni i OSBE-së në Shkup, BNJVL-ja, Agjencia për Rini dhe Sport, etj. Qendra Aarhus bashkëpunon me organizata në nivel kombëtar dhe rajonal. Në tetor 2023, ministri mori pjesë në Takimin Vjetor të Qendrave Aarhus, i cili u mbajt në Dushanbe, Tashkistan. Në nëntor 2023, u ndoq trajnimi dyditor "Mekanizmi për përputhshmëri sipas Konventës së Aarhus" i cili u mbajt në Beograd.

Sipas Ligjit për qasje të lirë në informatat me karakter publik, i cili është në përputhje me dispozitat e shtyllës së parë të Konventës së Aarhus-it (Direktiva për Qasje në Informatat për Mjedisin Jetësor), të gjithë poseduesit e informacionit janë të obliguar të veprojnë në pajtim me këtë ligj, gjegjësisht për të bërë publike informacionin publik (përfshirë informacionin për mjedisin jetësor), për të vepruar sipas një kërkesë të marrë nga një person fizik ose juridik, si dhe për të përgatitur një raport vjetor për trajtimin e kërkesave në lidhje me informacionin me karakter publik. Këto raporte përmbledhin kërkesat, përgjigjet dhe ankesat që janë bërë ndaj poseduesve të informacionit nga persona fizikë ose juridikë. Në këto raporte ka edhe kërkesa për informacion në lidhje me mjedisin jetësor, të cilat në periudhën e fundit janë përfaqësuar në një numër më të madh, të cilat mund t'i atribuojmë pjesërisht rritjes së ndërgjegjësimit të publikut për ruajtjen e të drejtës për informim dhe pjesërisht për përkeqësimin e cilësisë së mjedisit jetësor. Për sa i përket zbatimit të Direktivës për Pjesëmarrjen e Publikut në marrjen e vendimeve të rëndësishme për mjedisin jetësor ose shtyllës së dytë të Konventës së Aarhus-it, situata mund të barazohet me zbatimin e direktivave të VNM-së dhe VSM-së.

Dekreti për pjesëmarrjen e publikut në hartimin e rregulloreve dhe akteve të tjera, si dhe planeve dhe programeve në fushën e mjedisit jetësor, përveç dokumenteve planifikuese për të cilat publiku duhet të informohet dhe përfshihet, parashikon edhe kushtet, mënyrën dhe procedurën e pjesëmarrjes në publik gjatë përgatitjes së dokumenteve në fazën më të hershme të miratimit të tyre, si dhe përcaktimin e publikut të interesuar sipas kriterëve ekonomike, sociale, ekologjike. Ky Dekret parashikon gjithashtu informimin e publikut përmes përgatitjes së njoftimeve publike (vendi, koha dhe afati për shqyrtimin e dokumentit; vendi dhe koha e diskutimit publik; adresa ku mund të dorëzohen komentet; adresa elektronike nga ku mund të shkarkohet versioni elektronik i dokumentit, si dhe informacione të tjera që mund të kontribuojnë në realizimin e së drejtës së pjesëmarrjes së publikut të interesuar në vendimmarrje). Ky Dekret parashikon gjithashtu kushtet për pjesëmarrjen e publikut të interesuar (min. 1 diskutim), njoftimin e mbajtjes së tij, afatin dhe personin për kontakt për paraqitjen e komenteve etj.

Perceptimi i përgjithshëm është se përfshirja e publikut shmanget në fazën më të hershme ose pjesëmarrja është e kufizuar, ose organizohen dëgjime publike dhe ftohen palët e interesuara, por publikut nuk i jepet kohë e mjaftueshme për komente ose nuk merren parasysh të gjitha komentet. Raportet mbi konsultimet me publikun nuk janë të përfaqësuara në shumicën e rasteve.

Protokolli PRTR - Regjistri i shkarkimeve dhe transferimit të ndotësve (RSHTN), Konventa për qasje në informacion, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për çështjet mjedisore është vendosur. Gjithashtu është miratuar edhe një Rregullore për formën, përmbajtjen, metodologjinë dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit të shkarkimeve dhe transferimeve të ndotësve, i cili përcakton të gjitha detyrimet që dalin nga Rregullorja e BE-së (EC) Nr. 166/2006 dhe Protokolle. RSHTN-ja është krijuar,

ka një ueb-faqe dhe një bazë të dhënash, por ato nuk janë të përditësuara, nuk njihen dhe përdoren mjaftueshëm nga publiku.

Standardet minimale për zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese (RMCEI)

Sipas Ligjit për Mbikëqyrjen Inspektuese, përpilohen dy raporte: Raporti gjashtëmuor dhe raporti vjetor për punën e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit Jetësor - ISHMJ. Raportet gjashtëmuore për punën e ISHMJ-së miratohen nga Këshilli Inspektues (KI) dhe publikohen në ueb-faqen e ISHMJ-së me qëllim të informimit të publikut. Është përgatitur raporti vjetor i punës për të gjithë vitin 2023 dhe pas miratimit nga KI-ja, është publikuar në ueb-faqen e ISHMJ-së.

Rekomandimi i Parlamentit Evropian dhe Këshillit i datës 4 prill 2001 për sigurimin e kriterëve minimale për inspektimin në mjedisin jetësor në shtetet anëtare, është edhe përgatitja e planeve për inspektimin në mjedisin jetësor. Plani Vjetor i Punës së ISHMJ-së për vitin 2024 është publikuar edhe në ueb-faqen e ISHMJ-së.

Bashkëpunimi ndërkombëtar i ISHMJ-së në rrjetet evropiane, projekte dhe ngjarje të tjera nuk mungon as këtë vit. ISHMJ-ja është në komunikim dhe bashkëpunim me IMPEL, të gjitha me qëllim parandalimin e aktiviteteve të paligjshme ndërkufitare që mund të kenë ndikime të rëndësishme ndërkufitare.

Lidhur me vizitat në terren dhe raportet dhe konkluzionet pas vizitës në terren, rekomandimi është që ato raporte të jenë në dispozicion për publikun brenda dy muajve nga inspektimi. ISHM-ja publikon disa nga këto raporte, si dhe publikon informacione për inspektimet e kryera, të përmbledhura në një tabelë për çdo javë të kaluar.

Zbatimi i Standardeve Minimale për Zbatimin e Mbikëqyrjes Inspektuese (RMCEI), gjegjësisht Ligjit për Mbikëqyrjen Inspektuese në Mjedis Jetësor në nivel lokal përballet me sfida që duhet të tejkalohen, duke filluar nga mungesa e një inspektori të autorizuar në nivel lokal, për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi që mund të kenë konflikt interesash (si p.sh. një inspektor që kryen një inspektim, ose inspektim mjedisor dhe si pjesë e detyrave të tij të punës edhe miratimi i raporteve ose B - Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes).

Përgatitja e Propozim-programeve të përgatitura nga komunat dhe Qyteti i Shkupit, planet vjetore të përgatitura nga komunat dhe Qyteti i Shkupit dhe planet mujore për inspektim mjedisor nuk përgatiten nga shumica e komunave. Këto dokumente planifikuese, të cilat duhet të publikohen dhe të jenë në dispozicion në ueb-faqet e komunave dhe qytetit të Shkupit, nuk mund të gjenden në shumicën e komunave.

Direktiva për përfaqësimin e të dhënave hapësinore për mjedisin jetësor (INSPIRE)

Për sa i përket zbatimit të Direktivës INSPIRE, është bërë njëfarë progresi përmes hartimit të disa rregulloreve zbatuese (Rregullorja për meta të dhëna, Rregullorja e specifikimit të ndarjes së të dhënave dhe protokollat, si dhe Rregullorja e shërbimeve të rrjetit).

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përfshirë në mënyrë aktive në themelimin e Infrastrukturës Kombëtare për të Dhënat Hapësinore që nga fillimi dhe vazhdimisht investon në zhvillimin

e aplikacionit WEB GIS për mbledhjen, përpunimin dhe prezantimin e të dhënave gjeohapësinore nga fushëveprimi i operacioneve të Ministrisë, krijimi i sistemit të informacionit të bazuar në WEB dhe integrimi i të dhënave gjeohapësinore në një bazë gjeo-të dhënash sipas direktivës INSPIRE, etj.

Në periudhën e kaluar Agjencia e Kadastrës së Pasurive të Paluajtshme ka realizuar aktivitete për afrimin e përdorimit të këtij portali me publikun, gjegjësisht seminare me temën "Të dhënat e hapura", të cilat u dedikuan përfaqësuesve të qeverisë dhe institucioneve publike.

Direktiva për përgjegjësinë për dëmet e shkaktuara në mjedis jetësor

Sa i përket zbatimit të Direktivës për Përgjegjësi Mjedisore, nuk ka progres dhe mund të thuhet se situata është identike si në raportin e vitit të kaluar. MMJPH-ja ka krijuar Regjistrin e vlerësuesve të autorizuar në fushën e mjedisit jetësor. Në mënyrë identike, si në raportin e vitit të kaluar, janë 4 subjekte juridike të autorizuar për kryerjen e aktiviteteve - vlerësimin e dëmeve mjedisore, gjegjësisht vlerësimin e ndikimeve mjedisore dhe kuantifikimin e tyre, si dhe aplikimin e masave për uljen e dëmit mjedisor dhe përcaktimin e çmimit të tyre. Deri në këtë moment, nuk ka asnjë informacion për vlerësimin e dëmit mjedisor, gjegjësisht nuk ka asnjë raport për vlerësimin e dëmit mjedisor që është në dispozicion për publikun.

Lidhur me kërkesat e Direktivës, ofrohet asistencë teknike për të forcuar kapacitetet e strukturës administrative me një procedurë për të vlerësuar nëse dëmi në mjedisin jetësor ka ndodhur dhe nëse operatori është përgjegjës për veprimet e nevojshme korrigjuese, procedurat për palët e interesuara të hartojnë strategji për parandalimin, reduktimin dhe riparimin. Në kuadër të projektit IPA për të mbështetur zbatimin e legjislacionit horizontal, MMJPH-ja parashikon rishikimin e dispozitave për përgjegjësinë për dëmtimin e mjedisit jetësor.

Direktiva për krimin mjedisor

Sa i përket zbatimit të Direktivës për Krimin Mjedisor, nuk ka progres.

Ndryshimet në Kodin Penal u miratuan në shtator të vitit 2023 dhe janë shumë domethënëse. Ato përfaqësojnë një hap të rëndësishëm përpara në luftën kundër krimit ekologjik/mjedisor. Në veçanti, "ekocidi", i cili parashikon një dënim nga 10 vjet deri në burgim të përjetshëm në varësi të dëmit të shkaktuar, është një dispozitë penale që nuk parashikohet as në aktet penale të shumë vendeve anëtare të BE-së. Mbetet të shihet se si do të vërtetohen krimet dhe si do të ndëshkohen autorët e krimeve kundër natyrës dhe mjedisit jetësor.

2.3 Rekomandime për përmirësim

Rekomandimet për përmirësim janë marrë nga 2 raportet e mëparshme në hije dhe është bërë një analizë e realizimit të tyre gjatë vitit 2023. Më poshtë në tabelë janë të gjitha rekomandimet, për secilin tregohet se sa është zbatuar, si dhe jepet statusi që është zbatuar deri më tani në raport me secilin rekomandim.

Rekomandimi nga viti 2022	Masat e marra (Po/Jo/Pjesërisht)	Komente/Statusi
Direktiva për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Jetësor (VNM)		
Publikimi i një informacioni të shkurtër për njoftimin e zbatimit të projektit, vendimin për objektin e studimit të VNM-së, Draft-studimin e VNM-së, procesverbalin e shqyrtimit publik, raportin mbi përshtatshmërinë e studimit, vendimin e miratimit ose mosmiratimit, me një link ku mund të të gjendet.	Pjesërisht Vetëm për studimin e VNM-së	Publikohet vetëm një informacion i shkurtër në lidhje me vënien në dispozicion të Studimit të VNM-së.
Dokumentet e specifikuar duhet të publikohen me data, në mënyrë që të sigurohet parashikimi ligjor i ditëve të përcaktuara për komente nga publiku.	Pjesërisht Vetëm për studimin e VNM-së	Vetëm njoftimi i publikimit të Studimit të VNM-së publikohet me datë dhe tregon deri kur mund të dorëzohen komentet.
Draft Studimi i VNM-së do të publikohet në ueb-faqen e komunës në territorin e së cilës është planifikuar të zbatohet projekti, me qëllim përmirësimin e qasjes dhe përfshirjes së publikut.	Jo gjithmonë	Është një numër shumë i vogël i komunave që publikojnë informacione për zbatimin e procedurës së VNM-së në ueb-faqet e tyre.
Procesverbali i seancave publike duhet të përfshijë informacione për komentet e marra me shkrim, pavarësisht nëse ka apo jo, me arsyetimin e duhur për pranimin ose mospranimin e tyre.	Pjesërisht	Më shpesh, në procesverbal shënohen vetëm komentet e qytetarëve që ishin të pranishëm në seancat publike.
Të krijohet një organ i pavarur nga një grup ekspertësh që do të shqyrtojë dhe vlerësojë cilësinë e studimeve të VNM-së, me qëllim përmirësimin e tyre në të ardhmen.	Jo	
Të rishikohen Dekretet për aktivitetet dhe veprimtaritë për të cilat është e nevojshme të përgatitet një raport për mbrojtjen e mjedisit jetësor.	Jo	
Praktikimi i procedurës për vlerësimin e ndikimit ndërkuftar mjedisor të projektit që realizohet në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe anasjelltas (njohja e publikut me një projekt që është planifikuar në një vend fqinj dhe mund të ketë një ndikim të mundshëm në mjedisin jetësor në vendin tonë).	Jo gjithmonë	Zbatimi i kësaj procedure varet nga projekti, nëse dhe çfarë ndikimesh ndërkuftare ka, por jo gjithmonë zbatohet.

Direktiva për Vlerësimin Strategjik në Mjedis Jetësor (VSM)

Заякнубање на капацитетите на ЕЛС во Forcimi i kapaciteteve të NJQV-ve në lidhje me zbatimin e procedurës së VSM-së.	Po	Qendra Aarhus, në bashkëpunim me BNJVL-në dhe Misionin e OSBE-së, në vitet e kaluara vazhdimisht zhvillon trajnime për zbatimin e Konventës së Aarhusit në nivel lokal, me theks të veçantë në procedurën e VSM-së dhe përfshirjen e publikut në planifikimin urban.
Trajnime për punonjësit e departamenteve të urbanistikës për procedurën e VSM-së dhe cilat dokumente (plane, programe, strategji) i nënshtrohen kësaj procedure.	Po	
Bashkëpunim më i madh në nivel të vetëqeverisjes lokale ndërmjet punonjësve në departamentet e mjedisit jetësor dhe urbanistikës.	Pjesërisht	Në disa komuna ka bashkëpunim, në të tjera jo. Në komunat më të vogla, zakonisht një person i kryen të dyja procedurat
Formimi i administratës së përbashkët (urbanizmi dhe mjedisit jetësor) sipas mekanizmit të bashkëpunimit ndërkomunal të cilin ligjvënësi e inkurajon dhe e mbështet.	Pjesërisht	Në disa komuna ekziston dhe është funksional, por në komuna të tjera ekziston vetëm në letër. Shumë shpesh edhe punonjësit që duhet të jenë pjesë e këtij koncepti nuk e pranojnë atë, para së gjithash për shkak të rritjes së vëllimit të punës, dhe kompensimi financiar mbetet i njëjtë.
Krijimi i një portali elektronik në nivel kombëtar me informacion mbi procedurën dhe procedurën e plotë për VSM-në.	Jo	
Publikimi i një vendimi për (mos)zbatimin e VSM-së dhe një formular në ueb-faqen e miratuesit të dokumentit të planifikimit (të jetë në dispozicion 5 ditë nga dita e publikimit).	Pjesërisht	Pavarësisht indikacioneve nga Qendra Aarhus dhe shpjegimit të procedurës së trajnimit, disa nga autoritetet që prodhojnë dokumente planifikuese nuk e publikojnë vendimin.
Publikimi i njëkohshëm i Draft Dokumentit të Planifikimit dhe i Draft Raportit për VSM-në dhe njoftimi i datës së diskutimit publik, mënyra e pjesëmarrjes së publikut, afati për komente, etj.	Pjesërisht	Një numër shumë i vogël i organeve prodhuese të dokumenteve planifikuese publikojnë së bashku dokumentin e planifikimit dhe draft raportin e VSM-së.
Publikimi i procesverbaleve të konsultimeve me publikun duke përfshirë komentet verbale dhe me shkrim.	Jo	Pothuqse asnjë nga organet që prodhojnë dokumente planifikuese nuk i publikon Procesverbalet e konsultimeve me publikun veç e veç. Zakonisht gjendet në kuadër të Raportit Përfundimtar për VSM-në.
Publikimi i Draft Raportit Përfundimtar për VSM-në me komente nga publiku të përfshira.	Pjesërisht	Vetëm disa nga autoritetet e planifikimit publikojnë Raportin përfundimtar të VSM-së me komente nga publiku të përfshira.

Hartimi i një udhëzuesi me kompetencat e komunave, në nivel vendor, i cili parashikon procedurat për pjesëmarrjen e publikut.	Pjesërisht	Në kuadër të disa projekteve dhe nga disa shoqata të qytetarëve, janë përgatitur doracakë të ngjashëm, të cilët duhet të thjeshtohen dhe të vënë theksin në VSM-në dhe planifikimin urban në nivel lokal.
Ndryshimi i akteve nënligjore në fushën e mbajtjes së konsultimeve publike, kriteret për suksesin e konsultimeve publike, njoftimi dhe publikimi i informacionit, rishikimi i përmbajtjes së raporteve të VSM-së.	Jo	Pritet që Projekti IPA - "Mbështetje për zbatimin e legjislacionit horizontal" të rregullojë procedurën për vlerësimin strategjik të ndikimit në mjedisin jetësor me analizë të zbatimit të tij, si dhe një zbatim më të mirë të procesit të konsultimit publik.
Praktikimi i procedurës për vlerësimin e ndikimit ndërkufitar në mjedisin jetësor nga përgatitja e një dokumenti të caktuar planifikues në R. Maqedonia e Veriut dhe anasjelltas (njohja e publikut me përgatitjen e një dokumenti/plani në një shtet fqinj, i cili mund të ketë një ndikim të mundshëm në mjedisin jetësor në vendin tonë).	Pjesërisht	Për disa dokumente strategjike kombëtare praktikohet, për disa jo. Për Raportet e VSM-së për planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura (Parku Kombëtar, Monument i Natyrës) praktikohet.
Direktiva për qasjen në informacionin me karakter publik për mjedisin jetësor		
Rishikimi i dispozitave për qasjen në informacion me karakter publik për mjedisin jetësor.	Jo	
Përditësimi i Regjistrat të Ndotësve dhe Transferimit të Substancave Ndotëse - RNTN (Lajme në ueb-faqen e RNTN) – Lajme (moepp.gov.mk) janë nga viti 2019, Raporti i fundit i publikuar për zbatimin e Protokollit për Regjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve është i vitit 2013)	Jo	
Përditësimi i Strategjisë për zbatimin e Protokollit për regjistrat e shkarkimeve dhe transferimeve të ndotësve në Republikën e Maqedonisë	Jo	
Zbatimi i aktiviteteve për përditësimin e Kadastrës së ndotësve (ajër, ujë, zhurmë) dhe Regjistrin e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve (RSHTN).	Jo	
Zhvillimi i një Strategjie për zbatimin e Konventës së Aarhusit në R. Maqedonia e Veriut, e cila do të ofrojë udhëzime në përgatitjen e planit kombëtar të veprimit për zbatimin në praktikë të Konventës së Aarhus-it.		Ky rekomandim është i ri, i cili duhet të zbatohet në bashkëpunim me MMJPH-në dhe të gjitha subjektet përkatëse. Nevojiten konsultime të gjera me publikun (shoqatat e qytetarëve).
Ndryshimet në Ligjin për qasje të lirë në informatat me karakter publik (LQLIKP) në përputhje me Direktivën për qasje në informacione nga fusha e mjedisit jetësor.		Ky rekomandim është i ri, ka bashkëpunim të vazhdueshëm mes ASPI dhe Qendrës Aarhus dhe vullnet për të precizuar më tej informacionin publik në përputhje me Direktivën për qasje në informacionin për mjedisin jetësor.

Direktiva për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen e rëndësishme për mjedisin jetësor

Krijimi i një portali të ri, ueb-faqe që do të përmbajë udhëzime dhe këshilla se si publiku mund të marrë pjesë në procedura dhe cilat janë të drejtat dhe mundësitë e tij në proceset vendimmarrëse që lidhen me mjedisin jetësor.	Jo	
Të gjitha komentet e publikut duhet të merren parasysh dhe në fund të procedurës, organet kompetente duhet ta informojnë publikun për vendimin e marrë dhe arsyet e miratimit të tij duke hartuar një raport mbi konsultimin publik.	Pjesërisht	Një numër shumë i vogël i organeve vendimmarrëse përgatitnin raporte nga konsultimi publik dhe i publikojnë ato publikisht.
Krijimi i një udhëzuesi, me udhëzime të shkurtra dhe të qarta, kur dhe ku publiku ka të drejtë të marrë pjesë, kur dhe si të paraqesë komente dhe kujt, si dhe çfarë në rast se kjo e drejtë mohohet.	Pjesërisht	Në kuadër të disa projekteve dhe nga disa shoqata qytetarësh, janë përgatitur manuale të ngjashme, të cilët duhet të jenë të thjeshtuar dhe të qëllimshëm, të shkurtër dhe të qartë, të përmbajnë hapa dhe afate për të gjitha procedurat që kërkojnë pjesëmarrjen e publikut.
Përmirësimi i kapaciteteve të OSHC-ve për mundësitë që ofron legjislati për pjesëmarrjen e publikut në procesin e formimit të opinionëve dhe vendimmarrjes.	Po	Qendra Aarhus dhe shoqatat e tjera të qytetarëve në kuadër të projekteve janë duke punuar në vazhdimësi për promovimin e mundësive për mekanizmat e pjesëmarrjes publike që ofron legjislati.
Mënyrat e mundshme të organizimit të OSHC-ve për performancë të përbashkët për pjesëmarrjen e publikut në procese të caktuara.	Po	Organizimi joformal i shoqatave të qytetarëve që kanë interesa të përbashkëta në rrjete, si dhe përgatitja e komenteve, mendimeve dhe qëndrimeve të përbashkëta për zgjidhje të caktuara ligjore, po praktikohet gjithnjë e më shumë.
Përfshirja e publikut dhe siguri i pjesëmarrjes në procedurat e vlerësimit të ndikimit ndërkufitar në mjedisin jetësor të projekteve apo dokumenteve të planifikimit që planifikohen/përgatiten në territorin e R. Maqedonia e Veriut.	Pjesërisht	MMJPH-ja publikon Vendimet për nevojën e kryerjes së konsultimeve ndërkufitare në ueb-faqen e saj, por ato nuk janë në faqen kryesore, domethënë nuk janë të dukshme dhe lehtësisht të qasshme për publikun.
Zbatimi i rekomandimeve të Mاستrihtit për promovimin e pjesëmarrjes efektive të publikut në vendimmarrjen për mjedisin jetësor, në kuadër të Konventës së Aarhus-it.	Jo	Pritet që Projekti IPA – “Mbështetje për zbatimin e legjislatit horizontal” të përcaktojë kriteret për një zbatim më të mirë të procesit të konsultimit publik.

Direktiva për përfaqësimin e të dhënave hapësinore për mjedisin jetësor INSPIRE

Arritja e bashkëpunimit më të ngushtë me Agjencinë e Kadastrës së Pasurive të Paluajtshme (AKP), si autoritet kompetent për krijimin, mirëmbajtjen dhe ofrimin e qasjes publike në gjeoportalin e IKDH-së, mirëmbajtjen e shërbimeve të meta të dhënave, regjistrin e meta të dhënave dhe trajnimet përkatëse.	Jo	
Organet përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për IKDH-në duhet të shqyrtojnë mundësinë e përfshirjes së përfaqësuesve nga organizatat e shoqërisë civile që punojnë në fushën e mjedisit jetësor.	Jo	
Trajnim apo prezantim publik mbi mënyrën e përdorimit të “të dhënave falas” – të dhënat për mbrojtjen e mjedisit jetësor, si një nga shërbimet e Agjencisë së Kadastrës së Pasurive të Paluajtshme.	Po	Në Programet Vjetore për Infrastrukturën Kombëtare të të Dhënave Hapësinore, Agjencia e Kadastrës së Pasurive të Paluajtshme planifikon të zhvillojë trajnime për temat përkatëse (të destinuara për subjektet e IKDH-së)
Krijimi i një strategjie të re ose përditësimi i Strategjisë ekzistuese për IKDH-të dhe krijimi i programeve vjetore për zbatimin e saj.	Jo	
Përmbajtja e Strategjisë dhe afati i vlefshmërisë duhet të specifikohen në Ligj	Jo	
Digjitalizimi i të dhënave gjeohapësinore (në subjektet e IKDH-së ku ky shërbim nuk ofrohet)	Pjesërisht	Me ndryshimet e reja në ligjin ekzistues, parashikohet që subjektet e IKDH-së t'i digjitalizojnë të dhënat hapësinore brenda 2 viteve (fillimi i korrikut 2025)
Aktivitete për promovimin e IKDH-së në bashkëpunim me sektorin e OJQ-ve	Jo	

RMCEI – Standardet minimale për zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese

Hartimi dhe miratimi i Planit Kombëtar të Inspektimit Mjedisor	Pjesërisht	Sipas informacioneve tona, ende është duke u punuar për Planin e Inspektimit në Mjedisin Jetësor
Përditësimi i regjistrit elektronik për kontrollet e kryera në baza javore dhe/ose mujore	Po	
Hartimi dhe miratimi i një Strategjie Kombëtare për Inspektimin në Mjedisin Jetësor (brenda gjashtë viteve nga miratimi i Ligjit për Inspektimin në Mjedisin Jetësor - LIMJ)	Jo	Afati nuk është tejkaluar.

Zhvillimi dhe miratimi i Programit të Inspektimit të Mjedisit Jetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (brenda tre viteve nga miratimi i LIMJ)	Jo	Afati nuk është tejkaluar.
Emërimi i inspektorëve të autorizuar në të gjitha komunat apo vendosja e bashkëpunimit ndërkomunal (sipas LIMJ afati është 31.12.2022)	Pjesërisht	Në shumicën e komunave janë emëruar inspektorë të autorizuar të mjedisit jetësor, në disa përdoret mekanizmi i bashkëpunimit ndërkomunal dhe në disa komuna ende nuk janë emëruar inspektorë vendorë.
Direktiva për përgjegjësinë për dëmet e shkaktuara në mjedisin jetësor		
Është e nevojshme organizimi i provimeve profesionale për rritjen e numrit të vlerësuesve në fushën e mjedisit jetësor, ekspertëve që do të punojnë për çështjet e përgjegjësisë në mjedisin jetësor	Jo	Gjatë vitit 2023 nuk është organizuar asnjë provim profesional
Miratimi i akteve nënligjore të parashikuara në përputhje me Direktivën, të cilat i referohen përcaktimit të kriterëve për përcaktimin e dëmit në mjedis jetësor dhe përjashtimeve në të cilat nuk do të kërkohet përgjegjësi; përcaktimin e masave për sanimin e dëmit në mjedisin jetësor, etj.	Jo	
Zhvillimi i një analize të zbatimit të Direktivës në vendet fqinje, shkëmbimi i përvojave dhe aplikimi i praktikave më të mira	Jo	

Direktiva për krimet në mjedisin jetësor		
Organizimi i trajnimeve për prokurorët publikë, si dhe për gjyqtarët, me qëllim njohjen e tyre me elementët kryesorë të krimet të mjedisit jetësor, mënyrën e përcaktimit të dëmit dhe përcaktimit të përgjegjësisë.	Pjesërisht	Disa shoqata qytetarësh (Qendra për Kërkime Ligjore, CED Florozon, etj.) organizuan këtë lloj trajnimi gjatë viteve 2022-2023, i cili duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen.
Fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve kompetente për dispozita penale për dëmet e shkaktuara, krimet në mjedisin jetësor.	Pjesërisht	
Forcimi i kapaciteteve, interesave dhe motivimit të OSHC-ve për monitorimin dhe raportimin e krimeve në mjedisin jetësor.	Pjesërisht	
Krijimi i një baze të dhënash ose e-regjistri që do të përmbajë një pasqyrë të krimeve të kryera kundër mjedisit jetësor, i cili duhet të jetë në dispozicion publikisht.	Jo	
Ridestnimi i mjeteve nga gjocat e paguara për financimin e aktiviteteve për përmirësimin e mjedisit jetësor (në mungesë të Fondit për Mjedisin Jetësor, ato duhet të përfshihen në Programin e Investimeve në Mjedisin Jetësor, i cili do të rrisë fondet e parashikuara për financimin e aktiviteteve të OSHC-ve).	Jo	
Vendosja e kontaktit dhe bashkëpunimit me ekspertët e mjedisit jetësor (Regjistri mbahet nga Ministria e Drejtësisë) për marrjen e informacionit mbi zbatimin e procedimeve penale për krime kundër mjedisit jetësor ku kërkohen shërbime ekspertësh.	Jo	

3

Ajri



3 Ajri

3.1 Pasqyrë për progresin në nënkapitullin gjatë vitit 2023

Në nënkapitullin e cilësisë së ajrit nuk mund të vërehet pothuajse asnjë progres, veçanërisht në fushën e transpozimit të direktivave. I gjithë transpozimi dhe harmonizimi i legjislacionit "pret" projektin evropian që do të krijojë një ligj të ri për cilësinë e ajrit të ambientit, aktet nënligjore dhe dokumentet e planifikimit.

Sa i përket zbatimit të legjislacionit, situata është pak më e mirë, gjegjësisht ka progres të madh në përgatitjen e planeve për cilësinë e ajrit të ambientit dhe kjo për ato komuna që sipas LCAA-së janë të obliguara për t'i përgatitur ato.

Kapacitetet në administratë mbeten të dobëta dhe të pamjaftueshme, pra nuk ka asnjë ndryshim për sa i përket punësimit të stafit të ri, kështu që numri i të punësuarve në sektorin në MMJHP-së përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ajrit të ambientit mbetet i njëjtë. Veçanërisht shqetësues është fakti se vetëm një punonjës është ende përgjegjës për mirëmbajtjen e stacioneve të monitorimit. Në nivel lokal gjendja është edhe më e keqe, sidomos për shkak se komunat (edhe ato më të mëdha) kanë mbetur me 1-2 punonjës që janë përgjegjës për disa sektorë të mjedisit jetësor, përfshirë edhe ajrin.

3.2 Zbatimi i legjislacionit

Për sa i përket zbatimit të legjislacionit, një pjesë e madhe mbështetet edhe në projektin e BE-së, i cili aktualisht është në fazën e vlerësimit dhe me të cilin planifikohet krijimi i një numri të madh dokumentesh planifikuese, si dhe aktivitete për monitorimin e substancave të ndryshme ndotëse.

Sipas Direktivës për cilësinë e ajrit të ambientit dhe ajër më të pastër në Evropë (2008/50/EC), dokumentet e mëposhtme të planifikimit janë planifikuar në kuadër të projektit të mësipërm përmendur:

- **Plani Kombëtar për Mbrojtjen e Ajrit të Ambientit (për një periudhë 4 vjeçare);**
- **Programi Kombëtar i Kontrollit të Ndotjes së Ajrit (për një periudhë 10 vjeçare);**
- **Plan veprimi për zbatimin Planit Kombëtar për Mbrojtjen e Ajrit të Ambientit**

Gjithashtu, në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga kjo direktivë, vërehen përmirësime të caktuara në planin për cilësinë e ajrit të ambientit, zgjerimin e rrjetit të monitorimit, raportimin dhe informacionin nga dhe për aktorë të ndryshëm.

Planet e cilësisë së ajrit të ambientit në nivel lokal

Planet për cilësinë e ajrit të ambientit në nivel lokal duhet të përgatiten nga të gjitha komunat me mbi 35.000 banorë ose ato ku në vitin paraprak kishin tejkuluar vlerat kufirit sipas DAMSKAV-it. Çdo vit, MMJPH-ja– QIMMJ-ja publikojnë listën e komunave dhe aglomerateve ku janë tejkuluar këto vlera kufitare, jo më vonë se data 31.03 e vitit. Lista e zonave dhe aglomerateve ku janë tejkuluar vlerat kufitare në vitin e kaluar është në dispozicion në linkun e mëposhtëm: https://www.moepp.gov.mk/wp-content/uploads/2023/03/Lista_aglomeracii_2023.pdf, gjegjësisht MMJPH– QIMMJ publikon rregullisht listën në ueb-faqen e saj.

Pothuajse të gjitha komunat (përveç Tetovës dhe Berovës) të cilat sipas LCAA-së kanë pasur obligim të përgatisin, kanë hartuar plane për cilësinë e ajrit për komunën e tyre. Në vitin 2023, komunat e Kavadarit, Gostivarit dhe Manastirit i miratuan planet e tyre në Këshill, ndërsa Koçani dhe Kërçova janë ende në pritje të miratimit. Në vitin 2023, MMJPH-ja ka mbështetur financiarisht zhvillimin e planeve për Velesin, Ohrin, Prilepin, Strugën, Shtipin dhe Gjevgjelinë, të cilat tashmë janë përgatitur dhe shqyrtuar nga MMJPH-ja, dhe pritet të fillojë një proces konsultimi me publikun dhe finalizimi i tyre dhe miratimi i këshillave të komunave.

Komunat që kanë hartuar dhe miratuar një plan për cilësinë e ajrit të ambientit kanë detyrimin të monitorojnë zbatimin e planit dhe të raportojnë për zbatimin në baza vjetore. Të gjitha komunat që kanë një plan të vlefshëm kanë paraqitur raport, por zbatimi i masave është i pjesshëm, kryesisht lidhur me masat e subvencionimit, aktivitetet promovuese, aktivitetet e mbjelljes së pemëve dhe organizimin e ditës pa makina.

Përgatitja e raportit për masat e zbatuara për uljen e ndotjes së ajrit, që është përgjegjësi e MMJPH-së, nuk kryhet për shkak se MMJPH-ja nuk ka një plan kombëtar të vlefshëm për cilësinë e ajrit të ambientit. Plani është planifikuar të përgatitet në një projekt teknik në programin IPA II.

Zgjerimi i rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit të ambientit

Gjatë vitit 2023 përmes buxhetit të MMJPH-së është instaluar stacion i ri në Shtip dhe janë blerë instrumente për stacionet matëse (SM) të Lazaropole, Karposh, Qendër dhe disa instrumente për SM Gazi Babë dhe Miladinovci me mbështetjen e Bashkimit Evropian.

Është e nevojshme të punohet në mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrjetit të monitorimit për cilësinë e ajrit të ambientit sepse të dhënat janë të nevojshme për monitorimin e situatës, raportimin e komunave tek autoritetet kompetente dhe publikun dhe përgatitjen e dokumenteve planifikuese në nivel kombëtar dhe lokal. Më poshtë është dhënë një pasqyrë e të gjitha instrumenteve për të gjitha SM-të, sa ditë kanë punuar në 2023, gjegjësisht kanë dhënë informacion për përqendrimin e substancës ndotëse dhe sa është përqindja në nivel vjetor kur kanë punuar.

Tabela 1. Pasqyrë e instrumenteve të monitorimit të cilësisë së ajrit dhe ditëve kur kanë punuar gjatë 2023

Substanca ndotëse	Nuk punojnë	Punojnë	Total	Përqindje (%)
SO2	1087	6578	7665	85.82
PM10	1803	6227	8030	77.55
PM2.5	2151	5514	7665	71.94
CO	1379	6286	7665	82.01
O3	1363	6667	8030	83.03
TOTAL	7783	31272	39055	80.07

Burimi: Arkivi vetanak i Shoqatës së Juristëve të Rinj të Maqedonisë (SHJRM)

Njëkohësisht, gjatë vitit 2023 janë blerë pajisje të reja dhe është bërë përmirësimi i serverit të MMJPH-së, gjegjësisht i Qendrës Informative të Maqedonisë për Mjedisin Jetësor – QIMMJ), i cili do të mundësojë rrjedhje të qetë të informacionit për cilësinë e ajrit të ambientit. Për momentin, blerja ka përfunduar dhe transferimi i të dhënave në serverin e ri është në proces.

Njoftim dhe informim

Me qëllim të njoftimit dhe informimit përkatës në fazën përfundimtare është Sistemi Informativ Kombëtar për Mjedisin Jetësor (NEIS). Për momentin nuk është ende në dispozicion dhe nuk përdoret nga MMJPH-ja, por pritet të fillojë të funksionojë në vitin 2024. Deri më tani janë kryer trajnime me instalimet që në të ardhmen do të duhet të fillojnë përdorimin dhe raportimin përmes këtij sistemi dhe po punohet për eliminimin e mangësive të sistemit të konstatuara gjatë aplikimit praktik.

Akreditimi i Laboratorit Qendror të MMJPH-së

Laboratori qendror, gjegjësisht laboratorit punon me metodat ekzistuese që janë të akredituara. Megjithatë, mungon akreditimi i metodave për kalibrimin e instrumenteve, i cili mungon për shkak të mungesës së kapaciteteve njerëzore në laborator.

Akreditimi i laboratorit të kalibrimit për matjen e cilësisë së ajrit nuk është bërë ende.


Vlerësimi financiar se sa nevojitet për masat e ndotjes së ajrit

Një vlerësim i tillë është i domosdoshëm që të mund të pritët një lloj ndryshimi, pra trajtimi i planifikuar i ndotjes së ajrit, por ky vlerësim është planifikuar të bëhet edhe përmes projektit të BE-së i cili aktualisht është në fazën e përzgjedhjes së ofertuesit më të favorshëm dhe i cili pritet të fillojë të zbatohet deri në fund të vitit 2024.


Ndërkohë, stacionet e monitorimit regjistrojnë një tejkalim konstant të përqendrimeve të PM10 dhe PM2.5, veçanërisht në pothuajse të gjitha stacionet monitoruese gjatë sezonit të ngrohjes, si dhe përqendrimit vjetor që llogariten në bazë të përqendrimeve të matura me përjashtim të pak pikave matëse.

Grafikët në vijim tregojnë tendencat e përqendrimit të këtyre ndotësve.

Grafiku 1. Përqendrimi mesatar vjetor i PM10 në nivel vjetor (2005-2022) për të gjitha stacionet e monitorimit në vend




Grafiku 2. Përqendrimi mesatar vjetor i PM2.5 në nivel vjetor (2005-2022) për të gjitha stacionet e monitorimit në vend.



Për të dy substancat ndotëse, përqendrimit tregojnë një tendencë në rënie të përqendrimeve të matura në nivel vjetor, por megjithatë në shumicën e stacioneve ato janë mbi vlerat kufitare. Ndryshe është situata me dyoksidin e azotit, pra me këtë substancë ndotëse, përqendrimit që nga viti 2013 janë brenda vlerës kufitare vjetore.

Grafiku 3. Përqendrimi mesatar vjetor i NO₂ në nivel vjetor (2005-2022) për të gjitha stacionet e monitorimit në vend



Direktiva 2004/107/EC në lidhje me arsenikun, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin e ambientit

Për këtë direktivë ka progres minimal në zbatim sepse një pjesë e madhe e detyrimeve pritet të plotësohet me zbatimin e projektit të BE-së për zbatimin e Direktivave të Cilësisë së Ajrit, gjegjësisht është planifikuar të zhvillohen:

- ✓ **Plani për zbatimin e Direktivës (DSIP);**
- ✓ **Planet e monitorimit për metalet e rënda (HM), përbërjet organike të avullueshme dhe hidrokarburet aromatike policiklike (PAHs); dhe**
- ✓ **Krijimi i zonave dhe aglomerateve për metalet e rënda dhe PAHs RAN në përputhje me direktivën.**

Në kuadër të një projekti më të madh të implementuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), matjet e metaleve të rënda janë duke u zhvilluar për Kumanovën, Strumicën, Kavadarin, Strugën dhe Gostivarin (matjet kanë filluar në mars 2023), por përveç nevojës për matje më të rregullta indikativë, ajo që mungon është vendosja e monitorimit të rregullt për përbërjet organike të avullueshme (VOCs), PAHs dhe metalet e rënda.

Direktiva për kufijtë kombëtarë për emetimet e gazrave të shkarkimit 2016/2284/EC, (Direktiva NEC)

Detyrimet për përgatitjen e inventarizimit të substancave ndotëse dhe raportit informativ për inventarin sipas metodologjisë së përcaktuar në direktivë janë përbushur, pasi që nga viti 2016 raportohet rregullisht për të gjithë periudhat kohore. Raportimi sipas rrjeteve dhe burimeve të mëdha me pika kryhet gjithashtu sipas detyrimeve çdo 4 vjet duke filluar nga viti 2017. Projeksionet nuk raportohen ende pasi ato nuk janë llogaritur për 2025 dhe 2030 për substancat ndotëse NEC.

Për zbatimin e kësaj direktive po bëhen përgatitjet për llogaritjen e detyrimeve për reduktimin e substancave ndotëse. Aktiviteti ka filluar dhe do të zbatohet këtë vit, përmes projektit EU4Green, për vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Maqedoninë. Ky aktivitet është edhe mbështetje për plotësimin e kushteve për ratifikimin e amendamenteve të Protokollit të Goteborgut.


Sipas nenit 9 të kësaj Direktive, shteti ka detyrimin të monitorojë ndikimin e ndotjes së ajrit në eko sistemet (eco monitoring). Për këtë qëllim, në vitin 2023, përmes të njëjtit projekt (EU4Green), filloi krijimi i Udhërrëfyesit për Eko-monitorimin, por nevoja për burime financiare mbetet për të përcaktuar udhërrëfyesin dhe zbatimin e mëtejshëm të tij.

Inventari i emetimeve të ndotësve

Një inventar i shkarkimeve dhe emetimeve të substancave ndotëse bëhet rregullisht nga MMJPH-ja për periudhën 1990 deri në vitin aktual minus 2 vjet), pra inventari i fundit i referohet periudhës 1990-2022 dhe tashmë është dorëzuar përkatësisht në Agjencinë e Mjedisit Jetësor dhe Sekretariatit e Kombeve të Bashkuara më 14 shkurt 2024.¹ Grafiku më poshtë tregon emetimet e PM10, PM2.5, NH3, SOx dhe NOx për vitin 2022 dhe 1990 si vit bazë. Nga grafiku mund të shihet lehtësisht se emetimet për pothuajse të gjitha substancat ndotëse kanë shënuar ulje të ndjeshme, ku reduktimet e PM10 janë rreth 71%, ndërsa PM2,5 -74%.


Megjithëse është krijuar praktika e krijimit të një inventarizimi të emetimeve të substancave ndotëse, në kuadër të projektit EU4Green, janë planifikuar përmirësime në inventar edhe nëpërmjet aplikimit të niveleve më të larta të metodologjisë së llogaritjes. Deri më tani janë bërë përmirësime në inventarin në seksionin e shkarkimeve për sektorët e mbetjeve dhe bujqësisë. Në grafikun në vijim është një pasqyrë e reduktimeve të emetimeve nga Direktiva NEC për vitin e fundit 2022, krahasuar me vitin 1990.

¹ <https://cdr.eionet.europa.eu/mk/un/clrtap/inventories/envzwhna/>




Grafiku 4. Diferenca në nivelin e shkarkimeve të substancave ndotëse sipas inventarit kombëtar për periudhën 1990-2022

Grafikët në vijim tregojnë emetimet e PM 10 dhe PM 2.5 sipas sektorëve, ku ndryshimi i burimeve të shkarkimeve nga viti 1990 në 2022 është i dukshëm. Pra, për PM2.5, në vitin 1990, shumica e emetimeve (49%) vinin nga proceset industriale. Ky trend ka ndryshuar në vitin 2022, pra 71% e emetimeve janë nga amvisëritë, objektet tregtare dhe administrative. E njëjta situatë është edhe me emetimet e grimcave PM₁₀.




Grafiku 5. diferenca në emetimet e PM2.5 ndërmjet viteve 1990 dhe 2022 sipas sektorëve

PM10 (2022)



PM10 (1990)



Grafiku 6. diferenca në emetimet e PM 10 ndërmjet viteve 1990 dhe 2022 sipas sektorëve

Programi Kombëtar i Kontrollit të Emetimeve

Ajo që mungon dhe planifikohet të bëhet përmes projektit të BE-së që duhet të fillojë në vitin 2024 është përgatitja e një Programi Kombëtar për kontrollin e ndotjes së ajrit me të cilin do të angazhohemi për reduktime të caktuara të emetimeve të substancave ndotëse për periudhën 2026-2036.

Në programin kombëtar të kontrollit të emetimeve, projeksionet për emetimet nga sektorë të ndryshëm do të bëhen duke përdorur modele.

Reduktimi i detyrimeve për të reduktuar emetimet nga substancat ndotëse që i nënshtrohen kësaj direktive

Maqedonia nuk ka asnjë detyrim të raportojë për zvogëlimin e emetimeve të substancave ndotëse që janë objekt i Direktivës. Megjithatë, në kuadër të projektit EU4Green, për vendet e Ballkanit Perëndimor llogariten detyrime reduktimi (si pjesë e kërkesave të direktivës NEC), të cilat duhet të përfshihen edhe në aneksin e ndryshimeve në Protokollin e Goteborgut, për të cilat pasi të ratifikohen, do të kemi një detyrim të mëtejshëm për të reduktuar emetimet. Viti bazë që do të merret për të monitoruar reduktimet është 2005 dhe objektivat si përqindje reduktimi do të vendosen për 2020-2029 dhe 2030, e më tej.

Direktiva 2015/2193/EC për reduktimin e emetimeve të disa ndotësve të ajrit nga impiantet mesatare me djegie.

Nuk ka aktivitete për këtë Direktivë, gjegjësisht Direktiva nuk është transpozuar. Në periudhën e ardhshme është planifikuar të përgatiten plane specifike për zbatimin e Direktivës (DSIP) në projektin e ri IPA të BE-së, i cili duhet të fillojë në fund të vitit 2024.

Direktiva për përmbajtjen e sqfurit në benzinë - 2016/802/EC

Harmonizimi me dispozitat e Direktivës për lëndët djegëse të lëngëta me përmbajtje sqfuri është bërë me Rregulloren për cilësinë e lëndëve djegëse të lëngëta (Gazeta Zyrtare e RM nr. 88/2007). Sipas kësaj rregulloreje, Ministria e Ekonomisë miraton Planin Vjetor për monitorimin e cilësisë së vajit ekstra të lehtë për amvisëri dhe mazutit. Ky plan parashikon mënyrën e marrjes së mostrave, numrin e shpeshësisë së marrjes së mostrave, vendndodhjen nga ku janë marrë kampionet, analizat laboratorike dhe formën në të cilën bëhet raporti për matjet e vetive cilësore të vajit ekstra të lehtë për amvisëri dhe mazutit. Ky plan hartohet çdo vit dhe Inspektorati Shtetëror i Tregut kryen inspektime për kontrollin e cilësisë. Në raportin e ISHT-së nuk ka të dhëna se sa inspektime janë kryer në vitin 2023 në përputhje me këtë rregullore, përkatësisht inspektimet janë dhënë kolektivisht për të gjitha inspektimet që janë kryer në përputhje me Ligjin për sigurinë e produkteve.²

3.3 Rekomandime për përmirësim

Rekomandimet për përmirësimin e situatës së ndotjes së ajrit, si dhe zbatimin e legjislacionit, janë dhënë tashmë në raportin e parë në hije dhe janë zgjeruar në të dytin për vitin 2022. Këtë vit po analizojmë se cilat rekomandime janë zbatuar nga shteti dhe komunat.

Nr.	Rekomandimi	A është zbatuar rekomandimi?
	Legjislacioni për cilësinë e druve të zjarrit për përdoruesit përfundimtarë dhe përqindjen e lagështisë për drurin që shpërndahet	Është përgatitur draft-rregullore dhe është dorëzuar në Ministrinë e Ekonomisë, por nuk është harmonizuar dhe ende nuk është miratuar.
	Është e nevojshme që komunat të planifikojnë masa subvencionuese në buxhetet e tyre dhe shteti të punojë në uljen e % të TVSH-së për inverterët me efikasitet të lartë.	Pjesërisht
	Ndalohet përdorimi i lëndëve djegëse të ngurta në zonat urbane, veçanërisht aty ku ka sisteme të ngrohjes qendrore	Nuk zbatohet
	Formimi i PPP-ve apo i një lloji tjetër bashkëpunimi me sektorin privat me qëllim rritjen e numrit të termocentraleve që do të përdorin lëndë djegëse që emeton më pak lëndë ndotëse (BRE, biomasë, etj.).	Nuk zbatohet


² <https://dpi.gov.mk/images/stories/izvestaj/2023/%D0%94%D0%9F%D0%98%20%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98%20%D0%B7%D0%B0%20%D0%BF%D1%80%D0%B2%D0%BE%20%D0%BF%D0%BE%D0%BB%D1%83%D0%B3%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D0%B5%202023.pdf> <https://dpi.gov.mk/images/stories/izvestaj/2023/DPI-Izvestaj-2-polugodie-2023.pdf>

	Shfrytëzimi më i madh i rrjetit të shpërndarjes së ngrohjes (në qytetet ku tashmë është krijuar, nevojitet ndryshimi i zgjidhjeve ligjore, pra marrja e vendimeve në nivel lokal për përdorimin e detyrueshëm të sistemit të ngrohjes qendrore).	Nuk zbatohet
	Më shumë subvencione për inverterët për amvisëri	Pjesërisht e zbatuar. Ministria e Ekonomisë publikon çdo vit thirrje për blerjen e inverterëve për amvisëri. Përveç kësaj, disa nga komunat (Ohri dhe Qyteti i Shkupit) praktikojnë subvencione për amvisëri për blerjen e pajisjeve inverter.
	Përdorimi më i madh i burimeve të rinovueshme të energjisë në amvisëri, sektorin tregtar dhe industri. Për amvisëritë është e nevojshme të ofrohen subvencione në masën 30% të investimeve prej 6 kW për FV në çati në amvisëri.	Ministria e Ekonomisë shpall thirrje për subvencione për instalimin e FV për amvisëri. (Për termocentralet fotovoltaike janë ndarë 30 milionë denarë, për kolektorët termikë janë ndarë 25 milionë denarë).
	Rishikimi i skemës së matjes neto dhe çmimeve të energjisë elektrike të furnizuar në rrjet. Duke marrë parasysh vëllimin e zëvendësimit të konsumit të vet, si dhe faktin që energjia e tepërt e dorëzuar në rrjet nuk është e konsiderueshme, periudhat e kthimit të investimit janë më të gjata se projekti i deklaruar.	Nuk zbatohet
	Për të siguruar një transparencë më të madhe për shumën e tarifave nga lejet mjedisore A dhe B, se ku përfundojnë dhe si përdoren.	Nuk zbatohet
	Një fond që do të përdorë një pjesë të këtyre fondeve për zbatimin e masave që do të mundësojnë më pak shkarkime në ajër nga proceset industriale.	Nuk zbatohet
	Qeveria duhet të nisë zbatimin e masave për më pak përdorim të lëndëve djegëse fosile.	<p>Nëpërmjet Ministrisë së Financave po zbatohet një projekt i financuar nga Banka Botërore, me të cilin janë kryer inspektime energjetike për rreth 100 objekte publike. Në kuadër të të njëjtit projekt janë planifikuar edhe investime në masat e eficiencës së energjisë dhe ndryshime në mënyrën e ngrohjes.</p> <p>Një projekt i BE-së përmes programit IPA III ka siguruar fonde për investime për uljen e ndotjes së ajrit (Shkup, Manastir, Kumanovë dhe Tetovë), me të cilin janë planifikuar këto aktivitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Prokurimi i autobusëve për në Shkup (TNG) • 7 objekte për të cilat do të ndërrohet sistemi i ngrohjes në ndërtesat administrative (spitale dhe objekte shëndetësore). Për 3-4 shkolla, procesi i zëvendësimit do të nisë në vitin 2024 • Gjelbërim me 6000-7000 pemë të trajtuara

	Të ndryshohet korniza ligjore në mënyrë që shërbimet e inspektimit të mund të kryejnë inspektime në familje për të kontrolluar karburantin që përdoret për ngrohje.	Nuk zbatohet
	Djegia pa leje e gjësendeve të ndryshme dhe materiale në mjedis të hapur, si dhe në gjetjen e deponive të egra dhe djegien e tyre.	Nuk zbatohet
	Për të përcaktuar varfërinë energjetike dhe për të përcaktuar numrin e familjeve që janë kategori të cenueshëm.	Termi është i përcaktuar në Ligjin për Energjinë, Ministria e Ekonomisë çdo vit bën një plan për të mbështetur qytetarët e cenueshëm social.
	Krijimi i monitorimit të rregullt për VOC, PAH dhe HM	Matjet indikative janë në proces. Monitorimi i rregullt nuk kryhet
	Menaxhimi i mbetjeve (pastrimi dhe hartografimi i deponive ilegale). Mbikëqyrje e rregullt nga gardianët komunalë	Nuk zbatohet
	Transporti (të stimulohej masat për transport pa motor në zonat urbane, shtimi i shtigjeve për biçikleta, komunitat të vazhdojnë dhënien e subvencioneve por edhe të rrisin fondet për subvencionim blerja e skuterëve dhe biçikletave.)	Është zbatuar pjesërisht, por jo në të gjithë territorin e Maqedonisë
	Monitorimi i ajrit të ambientit duhet të jetë pjesë e një njësie të veçantë organizative që do të përfshijë krijimin e inventarëve dhe një departament për krijimin dhe monitorimin e zbatimit të legjisllacionit dhe masave të propozuara në dokumentet e planifikimit.	Banka Botërore po përgatit një analizë funksionale për sektorin e Qendrës Informativë të Maqedonisë për Mjedisin jetësor
	Një organ aktiv që do të mundësojë bashkëpunim ndërsektorial ndërmjet të gjitha institucioneve përkatëse që do të punojnë së bashku për zgjidhjen e problemit	Nuk është zbatuar – Grupi ndërsektorial është krijuar por nuk është aktiv
	Gjelbërimi urban dhe ruajtja e fondit pyjor - Duhet të zbatohen si duhet dispozitat e Ligjit të Ndërtimit për përqindje të detyrueshme, pra të mos neglizhohet përqindja e gjelbërimit që duhet të përmbajë çdo objekt i ri.	Projekti i Bankës Botërore
	Aktivitetet të rregullta për rritjen e gjelbërimit urban	Nuk zbatohet rregullisht
	Pyllëzimi i vendeve brenda dhe përreth qyteteve që luftojnë me ndotjen e ajrit	Nuk zbatohet rregullisht

4

Ujërat



4 Ujërat

4.1 Pasqyrë për progresin në nënkapitullin gjatë vitit 2023

Rezultatet e analizave treguan se në vitin 2023, në përgjithësi, është bërë pak progres në sektorin e ujit. Kapacitetet e dobëta institucionale dhe mungesa e fondeve vazhdojnë të jenë arsyt kryesore për harmonizimin dhe zbatimin e ngadalshëm dhe joefektiv të legjislacionit të BE-së në fushën e ujërave.

Në vitin 2023, nuk është bërë asnjë përparim në transpozimin e legjislacionit të BE-së për ujërat në legjislacionin kombëtar. Shkalla e harmonizimit me legjislacionin e BE-së për ujërat është e njëjtë në vitin 2023, domethënë varion nga 14% deri në 100% për direktivat e ndryshme të BE-së për ujërat. Akti kryesor ligjor që transponon legjislacionin e BE-së për ujërat në vend është Ligji për Ujërat dhe aktet nënligjore që dalin prej tij.

Në shkurt të vitit 2022 ka filluar procedura për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ujërat, e cila ende nuk ka përfunduar. Kjo është edhe arsyeja kryesore e stagnimit në harmonizimin me legjislacionin e BE-së në fushën e ujërave. Domethënë, sipas afatit të paraparë, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ujërat duhej të hynte në procedurë parlamentare që në fund të vitit 2022, pas së cilës duhej të hartoheshin gjashtë akte të reja nënligjore që do të rezultojnë nga Projektligji dhe miratoheshin brenda një viti Ligji për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Ujërat. Ligji i propozuar për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Ujërat dhe sot e kësaj dite, ka statusin i "hapur" në Regjistrin e Unifikuar Kombëtar të Rregulloreve në R. Maqedonia e Veriut (ENER; https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=72850). Për më shumë informata iu drejtuam Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nga ku u theksua se Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ujërat ende nuk ka hyrë në procedurë parlamentare dhe as nuk është miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Propozim Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për ujërat ka kohë që është në procedurë të harmonizimit me legjislacionin në Sekretariatit për Legjislacion të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Duke qenë se këtë vit ka zgjedhje parlamentare, miratimi i këtij Projektligji me gjasë do të jetë edhe më i zgjatur. Procedura të tilla të gjata për miratimin e ndryshimeve ligjore jo vetëm që tregojnë joefikasitetin e sistemit, por potencialisht mund të kenë pasoja negative për mjedisin (në këtë rast ujërat), pasi një kuadër ligjor për mbrojtje dhe mekanizma për mbrojtje më të mirë nuk parashikohen në menaxhimin në kohë të burimeve natyrore në vend.

Iniciativa për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ujërat (2022) është iniciuar për shkak të indikacioneve të mangësive në Ligjin ekzistues për Ujërat, nga Enti Shtetëror i Revizionit. Edhe pse në të njëjtin raport të revizionit janë konstatuar disa mangësi dhe janë dhënë rekomandime për to, vetëm një pjesë e tyre janë marrë parasysh dhe janë integruar në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujërat. Konkretisht, raporti i revizionit konstaton mangësitë kryesore në Strategjinë Kombëtare të Ujërave dhe rekomandon që "Ministria e Mjedisit Jetësor duhet të intensifikojë aktivitetet për miratimin e ndryshimeve në Ligjin për Ujërat, të cilat do të rregullojnë mënyrën e hartimit dhe përmbajtjen e Strategjisë Kombëtare të Ujërave, si dhe mënyrën e monitorimit dhe përditësimit të saj." Nuk është e qartë pse ministria përgjegjëse nuk vepron sipas këtij rekomandimi të Entit Shtetëror të Revizionit, megjithëse ka pasur mundësi që ai të përfshihet në Projektligjin e ri për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ujërat. Strategjia Kombëtare ekzistuese për Ujërat, në praktikë, është një dokument jofunksional për shkak të "mungesës

së objektivave dhe prioriteteve specifike strategjike, si dhe masave dhe aktiviteteve për zbatimin e saj” (Raporti i Revizionit 2019). Duke qenë se nuk janë marrë masa për përfshirjen e një dispozite që do të rregullonte mënyrën e përgatitjes dhe përmbajtjen e Strategjisë Kombëtare në Projektligjin aktual për Ndryshimet dhe Plotësimet, ekziston një probabilitet i lartë që ky dokument kyç strategjik për fushën e ujërave të të përgatiten edhe në të ardhmen me cilësi dhe praktika të dobëta.

Në vitin 2023 janë përgatitur ose miratuar një numër i vogël aktesh në fushën e ujërave, gjegjësisht:

- ✚ **Vendim për përcaktimin e zonave mbrojtëse për mbrojtjen e ujërave të objektit ujëmbledhës “Studençica”, masat mbrojtëse, kushtet, mënyra e përcaktimit të zonave mbrojtëse dhe paraqitjes hartografike” (Gazeta Zyrtare e RMV, 7/2023).**
- ✚ **Udhëzime administrative për përgatitjen e planeve operative për parandalimin e përmbytjeve;**
- ✚ **Rregullore për kushtet teknike, mënyrën dhe procedurën e monitorimit të ujërave të ujitjes;**
- ✚ **Rregullore për kushtet teknike, mënyrën dhe procedurën e monitorimit të ujërave nga kullimi i tokës.**

Aktet e përgatitura që nuk janë miratuar janë në proces konsultimi dhe mbledhjeje mendimesh ndërinstytucionale.

Në korrik 2023, Kuvendi i R. Maqedonia e Veriut miratoi Ligjin për Ratifikimin e Protokollit për Ujërat dhe Shëndetin, e cila është një marrëveshje ndërkombëtare sipas Konventës për mbrojtjen dhe përdorimin e rrjedhave ujore ndërkufitare dhe liqeneve ndërkombëtare (Helsinki, 1992). Objektivi kryesor i Protokollit është të mbrojë shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve nëpërmjet menaxhimit më të mirë të ujërave, duke përfshirë mbrojtjen e ekosistemeve ujore dhe parandalimin, kontrollin dhe reduktimin e sëmundjeve të lidhura me ujën. Ky Ligj (Protokoll) nuk rrjedh nga kërkesat e BE-së për harmonizimin e legjislacionit, por kontribuon në zbatimin e Direktivave të BE-së në fushën e ujërave.

4.2 Zbatimi i legjislacionit

4.2.1. Zbatimi i Direktivës Kornizë të Ujërave

Gjatë vitit të kaluar nuk është bërë asnjë progres në menaxhimin e pellgjeve lumore në vend. Planet e menaxhimit për asnjërin nga tre pellgjet e përmendura – Drini i Zi, Vardari dhe Lumin Strumicë nuk janë miratuar, as nuk janë finalizuar dhe pritet finalizimi i tyre në drejtim të harmonizimit të metodologjisë. Statusi i Këshillave për pellgjet e lumenjve mbetet i njëjtë, pra Këshillat janë konstituuar, por ende nuk janë funksionale. Gjithashtu nuk ka progres në përcaktimin/deklarimin e zonave të ndjeshme ndaj eutrofikimit.

Në vitin 2022 u përgatit Libri i Ujit (baza e të dhënave për menaxhimin e ujërave) dhe metodologjia për monitorimin e trupave ujorë. Duke kryqëzuar të dhënat nga Libri i Ujit dhe nga monitorimi, për të cilin është përgjegjëse Drejtoria për Punë Hidrometeorologjike (DPHM), mundësohet zbatimi i politikave dhe masave të qëndrueshme për përdorimin dhe mbrojtjen e ujërave, si dhe një transparencë më e

madhe të procesit. Për t'i bërë më transparente të dhënat për ujin në vend, janë krijuar dy portale online përmes të cilave publiku mund të ketë një pasqyrë të të dhënave nga Libri i Ujit dhe monitorimi. Për fat të keq, publiku nuk ka qenë në gjendje të hyjë në portalin DPHM-së për monitorimin e ujit për një kohë të gjatë, kështu që për qëllimet e këtij raporti nuk mundëm të fitojmë njohuri për gjendjen e burimeve ujore në vitin e kaluar, as për suksesin e monitorimit në përputhje me metodologjinë e re. Kjo bie ndesh me dispozitat e Direktivës Kornizë për Ujërat dhe është e nevojshme që portali të jetë sërish në dispozicion sa më shpejt që të jetë e mundur që qytetarët të kenë një pasqyrë të cilësisë së mjedisit në të cilin jetojnë.

Të dhënat e vetme për cilësinë e ujit në vend në të cilat mund të kemi qasje janë ato nga "Raporti vjetor për cilësinë e mjedisit jetësor për vitin 2022", i cili përgatitet çdo vit nga Qendra Informativë e Maqedonisë për Mjedisin Jetësor (raporti vjetor për 2023 është në përgatitje dhe do të lëshohet në qershor 2024). DPHM-ja dorëzon në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të dhënat për cilësinë fiziko-kimike të ujit për vetëm 20 pika matëse të lumenjve në vend. Sipas këtyre matjeve, ujërat nuk janë të një cilësie të kënaqshme, pra i përkasin klasës I - IV varësisht nga cili parametër fiziko-kimik bëhet fjalë. Siç thuhet në Raportin e Parë në Hijë, liqenet natyrore në vend nuk mbulohen nga monitorimi operacional, gjë që është një lëshim i madh. Raporti vjetor i cilësisë së mjedisit jetësor për vitin 2022, përfshinë vetëm të dhëna për liqenin e Prespës, të cilat tregojnë se ujërat në liqen janë mesatarisht eutrofikë deri në eutrofikë. Edhe nga këto të dhëna të pakta mund të konstatohet se cilësia, pra gjendja ekologjike e shumicës së ujërave në vend është nën nivelin e përcaktuar me ligj "status të mirë ekologjik". Është e nevojshme të merren masa të menjëhershme dhe të gjera për të reduktuar ndotjen e ujit në vend në terma afatgjatë. Gjithashtu është e nevojshme të merren masa urgjente për përmirësimin e monitorimit të ujërave në vend, pra të zbatohet "Rregullorja e re për metodologjinë dhe procedurën e përcaktimit të parametrave për matjen dhe monitorimin e cilësisë dhe sasisë së të gjithë trupave ujorë", me qëllim për zbatimin e duhur të Direktivës Kornizë të BE-së për Ujërat.

4.2.2. Zbatimi i Direktivës së BE-së për Ujërat e Zeza Urbane

Gjatë periudhës së kaluar janë ndërmarrë hapa për uljen e ndotjes së Liqenit të Dojranit, i cili ka statusin e liqenit hiper-eutrofik. Kjo situatë është pasojë e futjes së sasive të mëdha të lëndëve ushqyese në liqen përmes derdhjes së ujërave të zeza urbane në mënyrë të pamjaftueshme të pastruara. Kjo bie ndesh me dispozitat e Ligjit për Ujërat dhe Direktivës Kornizë të BE-së për Ujërat, të cilat përcaktojnë se të gjithë trupat ujorë duhet të kenë një status të mirë mjedisor.

Masat konkrete që janë ndërmarrë janë: ndërtimi i një impianti të ri për trajtimin me kapacitet 3000 EJ për vendbanimet Star Dojran-Sretenovo-Nov Dojran, ndërtimi i dy ligatinave të ndërtuara për trajtimin natyror të ujërave të zeza në pellgun e Liqenit të Dojranit në vendbanimet Furka dhe Crniçani, si dhe rehabilitimi i sistemit kryesor grumbullues për ujërat e zeza në një gjatësi prej 8 km. Masat zbatohen me ndihmën financiare të Qeverisë së R. Maqedonia e Veriut dhe përmes projektit "Forcimi i mbrojtjes së monumentit natyror – Liqeni i Dojranit përmes përmirësimit të trajtimit të ujërave të zeza në komunën e Dojranit", i cili financohet nga Komuna e Dojranit dhe Qendra Ndërkombëtare e Ndihmës R. Sllovenisë. Zbatimi i këtyre masave dhe vënia në punë e impianteve të trajtimit pritet më së voni deri në maj të vitit 2025. Ky përfaqëson një shembull të mirë të iniciativave dhe praktikave në nivel lokal, të cilat kontribuojnë në përmirësimin e zbatimit të dispozitave të Direktivës së BE-së për Ujërat Urbane dhe Direktivës Kornizë për Ujërat.

Në anën tjetër, ende nuk ka filluar ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza për qytetin e Shkupit që është projekt kapital që do të mundësojë trajtimin e ujërave të zeza për më shumë se gjysmë milioni banorë. Mjetet financiare për ndërtimin e impiantit të trajtimit të ujërave të zeza janë siguruar përmes EIB (Banka Evropiane e Investimeve) me një grant prej 68 milionë (nënshkruar në vitin 2019) dhe një grant investimi prej 70 milionë eurosh të Bashkimit Evropian përmes Western Balkans Investment Framework (nënshkruar në mars 2023). Ka përfunduar me sukses një procedurë tenderimi dhe është përzgjedhur kontraktori më i favorshëm, por deri më tani nuk ka nisur ndërtimi i impiantit të trajtimit për shkak të procedurave të papërfunduara ligjore për urbanistikën. (<https://www.eib.org/en/stories/north-macedonia-water-development>). Afatet për këtë projekt kapital tashmë kanë kaluar dhe ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave nuk do të përfundojë në afatin e paraparë të vitit 2026, kryesisht për shkak të mosmarrëveshjeve politike dhe kapaciteteve të dobëta administrative në qytetin e Shkupit.


Sipas informacioneve të marra nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas tri përpjekjeve të pasuksesshme në vitet e kaluara, gjatë muajit të ardhshëm pritet të shpallet procedura e tenderit për ndërtimin e një impiantit për trajtimin e ujërave në qytetin e Manastirit. Procedura e tenderit për ndërtimin e një impiantit për trajtimin e ujit për qytetin e Tetovës tashmë është në proces dhe sipas tij ndërtimi i tij duhet të fillojë deri në fund të këtij viti. Ndërtimi i këtyre dy impianteve të trajtimit do të përmirësojë ndjeshëm ecurinë e zbatimit të Direktivës së BE-së për Ujërat e Zeza.

Gjendja e ujërave të zeza komunale në vend

Të dhënat e Entit Shtetëror të Statistikave tregojnë një trend të rritjes së ndotjes së ujërave natyrore me shkarkimin e ujërave të zeza komunale të patrajtuara. Gjegjësisht, siç tregohet në grafikun 7, në vitin 2022 ka pasur një rritje prej 9% të sasisë së ujërave të zeza të patrajtuara që janë shkarkuar në krahasim me vitin 2021.


Disponueshmëria e shërbimit të ujit për grumbullimin dhe shkarkimin e ujërave të zeza ndryshon ndjeshëm në rajone të ndryshme të vendit, domethënë, mesatarisht 79% e ujërave të zeza komunale mbledhen dhe largohen (Grafiku 8). Një përmirësim i konsiderueshëm në qasjen në shërbimet e grumbullimit dhe shkarkimit të ujërave të zeza në vitin 2022 është arritur në rajonet juglindore dhe të Shkupit, ndërsa pjesa tjetër e rajoneve shohin një rënie në këtë trend.

Ujërat e zeza të shkarkuara (në njëmijë m³)



Grafiku 7 Analiza krahasuese e ujërave të zeza të shkarkuara (Burimi i të dhënave Enti Shtetëror i Statistikave).


Grumbullimi dhe largimi i ujërave të zeza



Grafiku 8. Shërbimi i ujit për grumbullimin dhe largimin e ujërave të zeza (Burimi: Raporti vjetor i punës së Komisionit Rregullator për Energji dhe Shërbime të Ujit të RMV-së në vitin 2022).

Për sa i përket shërbimit të trajtimit të ujërave të zeza, tendenca e përgjithshme tregon një rënie të përqindjes së disponueshmërisë së këtij shërbimi vitet e fundit në të gjithë vendin. Situata është më e mira në rajonin Jugperëndimor, ku më parë mbulohej 111% me shërbimin e trajtimit të ujërave të zeza.

Trajtimi i ujërave të zeza



Grafiku 9. Shërbimi i ujit për grumbullimin dhe largimin e ujërave të zeza (Burimi: Raporti vjetor i punës së Komisionit Rregullator për Energji dhe Shërbime të Ujit të RMV-së në vitin 2022).

Konkluzioni: Analiza tregoi se në përgjithësi në vitin 2023 është arritur njëfarë progresi në zbatimin e Direktivës së BE-së për ujërat e zeza, por është e nevojshme të merren masa edhe më të gjera për të reduktuar sasinë e ujërave të zeza në vend dhe për të arritur qëllimet e përcaktuara nga Direktiva e BE-së për ujërat e zeza.

4.2.3. Zbatimi i Direktivës së BE-së për ujin e pijshëm

Programi i menaxhimit të ujit është instrumenti kryesor financiar me të cilin Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor aktualisht, çdo vit, financon menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve ujore në vend. Programi financon projekte dhe punime të tjera të komunave dhe shoqërive të ujësjellësve që bëjnë pjesë në një nga 4 kategoritë: Ndërtimi i objekteve të reja dhe mirëmbajtja dhe përmirësimi i objekteve publike ekzistuese të ujësjellësit, rregullimi i rrjedhave ujore me qëllim të mbrojtjes nga efektet e dëmshme të ujit, Zhvillimi i planeve për menaxhimin e pellgjeve lumore, si dhe pagesa e detyrimeve të prapambetura. Sipas raportit të revizionit për punën e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të përgatitur në vitin 2023 nga Enti Shtetëror i Revizionit, janë identifikuar mangësitë kryesore në zbatimin e këtij programi. Në raport thuhet se “në kuadër të Programit të përmendur nuk është krijuar një sistem objektiv dhe real i përzgjedhjes së projekteve, ku ekziston rreziku i veprimit subjektiv në përzgjedhjen e projekteve pa kritere të qarta, si dhe mundësia e përdorimit të papërshtatshëm dhe të paligjshëm të fondeve. për shkak të mungesës së kriterëve dhe rregullave specifike për zbatimin e këtyre projekteve”. Kjo paraqet një problem madhor, i cili duhet të adresohet urgjentisht, për të mundësuar progres të barabartë dhe efikas në zbatimin e Direktivave të BE-së për ujërat.

Nëpërmjet Programit të Menaxhimit të Ujërave, në vit sigurohen mesatarisht 681.000,00 euro, të cilat investohen në njërin nga katër kategoritë e lartpërmendura. Edhe pse institucionet përgjegjëse kombëtare tregojnë një përkushtim të vazhdueshëm për zgjidhjen e problemeve dhe sfidave me menaxhimin e ujit, megjithatë, për zbatimin dhe arritjen e plotë të objektivave të legjislacionit të BE-së për ujërat nevojiten më shumë se 2 miliardë euro investime kapitale (Eptisa, 2018). Kjo tregon se është e nevojshme që shteti të shumëfishojë investimet financiare vjetore në sektorin e ujërave.


Shembull i mirë i angazhimit shtesë financiar të shtetit është projekti për “Përmirësimin e infrastrukturës ujore të komunave në Maqedoninë e Veriut”, të cilin Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor filloi ta zbatojë në vitin 2023. Projekti realizohet me asistencë financiare – kredi nga Banka Evropiane e Investimeve në vlerë prej 50 milionë euro (kontrata është nënshkruar në nëntor 2022). Qëllimi kryesor i projektit është ndërtimi i infrastrukturës së re ose rehabilitimi i infrastrukturës ekzistuese për furnizimin me ujë, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza, si dhe masat emergjente për mbrojtjen nga përmytjet për të 80 komunat në vend. Për këtë qëllim, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor ka zhvilluar një metodologji për ndarjen e burimeve financiare, e cila është miratuar në korrik 2023 (Gazeta Zyrtare e RMV 166/2023). Sipas metodologjisë, secila komunë do të marrë në mënyrë të barabartë 200.000 euro, ndërsa pjesa tjetër prej 16.000.000 euro do të shpërndahet në mënyrë të barabartë për secilën nga komunat dhe komunat në qytetin e Shkupit sipas indeksit për zhvillim komunal dhe përqindjes së shpërndarjes sipas rajoneve planore, pas klasifikimit sipas shkallës së zhvillimit, ndërsa pjesa e mbetur prej 18.000.000 euro do të shpërndahet varësisht nga numri i popullsisë në komuna - 70% dhe numri i vendbanimeve - 30%. Të gjitha komunat tashmë kanë dorëzuar projekt propozime, të cilat aktualisht janë duke u shqyrtuar nga ekipi i ekspertëve të projektit të formuar për këtë projekt. Realizimi fillestar i disa prej projekteve nëpër komuna pritet të fillojë tashmë këtë vit, ndërsa përfundimi i plotë i projektit parashikohet për pesë vjet.

Gjendja e furnizimit me ujë në vend

Mbulimi i furnizimit me ujë në vend ndryshon ndjeshëm nga 59% në 100%, në varësi të rajonit. Në vitin 2022, përqindja e mbulimit me ujësjellës u rrit në rajonet e Vardarit, Jugperëndimit, Pellagonisë dhe Veri-Lindore, ndërsa në rajonet e tjera ka pasur një rënie të lehtë ose ka mbetur në të njëjtin nivel (Grafiku 10). Në vitin 2022, rajoni verilindor arrin mbulimin e plotë të popullsisë me ujësjellës, gjë që tregon proaktivitetin e institucioneve përgjegjëse në nivel kombëtar dhe lokal.


Uji për të cilin nuk arkëtohen të ardhura, pra humbjet e ujit nga sistemet publike, po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme nga pikëpamja e mbrojtjes së burimeve natyrore dhe kompanitë e ujësjellësit në të gjithë vendin po përballen me humbje të mëdha uji. Sipas të dhënave të disponueshme nga raporti vjetor i Komisionit Rregullator për Energjinë dhe Shërbimet e Ujit të RMV, përqindja e ujit që nuk arkëtohen të ardhura në nivel të gjithë vendit u rrit nga 60,46% në vitin 2021 në 62,42% në vitin 2022 (shprehur si përqindje e prodhimit total të ujit). Analiza sipas rajoneve tregon se në rajonet Jugperëndimore dhe Pellagonisë ka një përkeqësim të ndjeshëm të humbjeve të ujit prej 9-12% në vetëm një vit. Por në të njëjtën kohë ka një përmirësim të dukshëm në rajonin verilindor nga 74% në 21%, çka tregon se institucionet përgjegjëse kanë marrë masa efektive për parandalimin e humbjeve të ujit në ujësjellësit në këtë rajon. Përqindja e ulët e ujit që nuk arkëtohen të ardhura e arritur në rajonin verilindor është në nivelin e humbjeve mesatare të ujit në Bashkimin Evropian (23%). Këto të dhëna tregojnë për praktika të mira në zbatimin e Direktivës së Ujit të Pijshëm, të cilat duhet të përsëriten edhe në rajone të tjera të vendit.

Mbulimi i furnizimit me ujë



Grafiku 10. Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë.

Uji për të cilin nuk arkëtohen të ardhura



Grafiku 11. Për ujin që nuk arkëtohen të ardhura, i shprehur si përqindje e prodhimit total të ujit.

Konkluzion: Progres i pjesshëm është arritur në disa rajone drejt zbatimit të dispozitave të legjislacionit të BE-së për ujërat, por është e nevojshme të forcohen ndjeshëm përpjekjet dhe investimet në sigurimin e ujit të pastër dhe të sigurt për të gjithë qytetarët në vend. Është për keqardhje fakti që humbjet mesatare të ujit në nivel të gjithë vendit janë rritur në vitin 2022 dhe se në Republikën e Maqedonisë së Veriut përqindja e ujit për të cilin nuk arkëtohen të ardhura është më shumë se dyfish në krahasim me shtetet

anëtare të Bashkimit Evropian. Duhet të merren masa urgjente për të investuar në zbulimin e rrjedhjeve të tubacioneve të ujit, si dhe për të investuar në zëvendësimin e infrastrukturës të rrënuar të ujit.

4.2.4. Zbatimi i Direktivës së BE-së për ujërat nëntokësorë

Në vitin 2023 përfundoi projekti i Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim, i financuar nga Qeveria Zvicerane, me të cilin u krijua Regjistri Kombëtar i Ujërave nëntokësore. Kjo mundëson konsolidimin e të dhënave të shpërndara për ujërat nëntokësorë në territorin e shtetit.

Agjencia Zvicerane për Zhvillim vazhdon mbështetjen e saj në fushën e ujërave nëntokësorë, përmes Programit për Menaxhimin, Përdorimin dhe Mbrojtjen e Ujërave Nëntokësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Menaxhimit të Ujërave, e cila filloi të zbatohet në janar 2024. Ky program do të forcojë kapacitetet e institucioneve përkatëse në nivel kombëtar dhe vendor për menaxhimin e ujërave nëntokësore dhe do të kontribuojë në përmbushjen e kërkesave dhe integrimin më të mirë të legjislacionit të BE-së në lidhje me burimet ujore.

4.3 Rekomandime për përmirësim

Nga tabela në vijim (Tabela 2) mund të shihet se nuk është ndërmarrë asnjë veprim i duhur për asnjë nga rekomandimet e bëra në Raportin e vitit 2022, me përjashtim të disa përparimeve në rritjen e nivelit të ulët të financimit në sektorin e ujit.

Tabela 2. Rekomandime nga Raporti në hije i vitit 2022

Rekomandime nga 2022	Masat e marra (Po/Jo/Pjesërisht)
Rishikimi i Strategjisë Kombëtare ekzistuese për Ujërat	Jo
Plotësimi i pjesës së Ligjit për Ujërat që i referohet Strategjisë Kombëtare të Ujërave, duke shtuar një nen ose detyrim për miratimin e një akti nënligjor që do të përcaktojë më nga afër metodologjinë e zhvillimit dhe miratimit të strategjisë, përcaktojnë përmbajtjen minimale të strategjisë dhe caktoi afate për rishikimin dhe përditësimin e detyrueshëm të strategjisë	Jo
Zhvillimi dhe miratimi i një baze të re të menaxhimit të ujërave, ose përfshirja e këtij dokumenti në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Ujërave	Jo
Finalizimi dhe miratimi i të katër planeve të menaxhimit të pellgjeve lumore	Jo
Miratimi i të gjitha akteve nënligjore të përcaktuara me Ligjin për Ujërat	Jo
Zhvillimi i një programi monitorimi dhe vendosja e monitorimit operacional të të gjithë trupave ujorë në vend	Jo

Marrja e të gjitha sistemeve të furnizimit me ujë nga shoqëritë publike/shoqëritë e ujësjellësit	Jo
Zhvillimi i një fushate për edukimin e popullatës për lidhjen me rrjetin publik të furnizimit me ujë	Jo
Zbatimi i një politike proaktive dhe sigurimi i reduktimit të sasive të ujit që nuk arkëtohen të ardhura / i humbur	Jo
Forcimi i kapaciteteve të shërbimeve publike	Jo
Rritje drastike e buxhetit për menaxhimin e ujërave	Pjesërisht
Kryerja e një analize funksionale të kapaciteteve institucionale për menaxhimin me ujëra	Jo

Rekomandimet nga Raporti i mëparshëm mbeten të rëndësishme, por duke pasur parasysh presionin në rritje mbi burimet natyrore dhe ndikimin në rritje të ndryshimeve klimatike në vend, gjatë periudhës së ardhshme institucionet kombëtare dhe lokale duhet të fokusohen në:

- ↳ **Uljën e përqindjes së ujit që nuk arkëtohen të ardhura;**
- ↳ **Rritja e përqindjes së grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të zeza;**
- ↳ **Përcaktimi i zonave të ndjeshme ndaj eutrofikimit;**
- ↳ **Miratimi dhe zbatimi i Planeve të menaxhimit të pellgjeve lumore.**

Parakusht për zbatimin e këtyre rekomandimeve është rritja e shumëfishtë e financave në sektorin e ujërave, si dhe fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse.

5

Menaxhimi i mbetjeve



5 Menaxhimi i mbetjeve

5.1 Pasqyrë për progresin në nënkapitullin gjatë vitit 2023

Në sektorin e menaxhimit të mbetjeve nuk ka pasur progres në harmonizimin e legjislacionit kombëtar me atë evropian, pra asnjë nga aktet nënligjore të hartuara nuk është miratuar në vitin 2023. Aktet³ nënligjore të hartuara të cilat duhet të sigurojnë një zbatim më të mirë të Ligjit për Menaxhimin e Paketimeve dhe Mbetjeve të Paketimit (LMPMP), (Fletorja Zyrtare e RMV nr. 215/21) dhe që janë hartuar që në vitin 2022 nga personat përgjegjës në Ministrinë e Mjedisit Jetësor ende nuk janë miratuar për shkak të pengesave administrative në Sekretariatit e Legjislacionit. Për të njëjtat arsye edhe aktet⁴ nënligjore që dalin nga Ligji për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit për menaxhimin e rrjedhave të posaçme të mbetjeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 215/21) janë ende në pritje që të tejkalohen procedurat administrative dhe të miratohen.

Për sa i përket mbrojtjes së specieve me rëndësi evropiane, gjegjësisht kafshëve të mëdha, kërkimet për rrëqebullin e Ballkanit kanë vazhduar, si dhe ka filluar monitorimi gjenetik (në bashkëpunim me ekspertë nga Sllovenia) për të monitoruar tendencën e çiftëzimit brenda llojit (inbreeding) si një nga kërcënimet më aktuale të kësaj popullate. Zhvillimet aktuale me prezencën e ariut të murrmë në fshatrat e PK të Mavrovës inicuan diskutime në mesin e publikut profesional në vend dhe në rajon për mundësitë e përballje me situata të tilla - u formua një ekip intervenimi, u morën masa nga Institucionin Publik PK i Mavrovës për pastrimin e plehrave dhe aksione të tjera, të sigurohet kontejnerë me “sprej piper”, etj. Ka filluar zhvillimi i planeve të veprimit për menaxhimin e specieve - ariu i murrmë (*Ursus arctos*) dhe breshkës së fushës (*Testudo hermanni*) dhe habitatet – ligatina në pyll (91D0) në kuadër të projektit për përmirësimin e kapaciteteve për Natura 2000 dhe CITES.

Helmimi i paligjshëm i kafshëve të egra është një nga kërcënimet më të mëdha për biodiversitetin në botë, por ka ndikim edhe në shëndetin publik. Është metoda më e përdorur për shfarosjen e grabitqarëve në zonat rurale, si pasojë e ndërëgjegjësimit të ulët të qytetarëve dhe kapaciteteve të dobëta të institucioneve shtetërore. Me vendim të Ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është formalizuar grupi punues kombëtar për luftimin e helmeve, i cili paraqet një hap përpara për forcimin

e bashkëpunimit ndërinstitucional që nevojitet për të shtypur këtë lloj krimi mjedisor. Gjithashtu është punuar për përpunimin e Planit të Veprimit për luftën kundër helmeve si dhe Procedurës Standarde të Operacionit për trajtimin e krimeve të tilla në bashkëpunim me inspektoriatet (ISHMJ, ISHPGJ), prokurorët publikë, AUV, MPB, etj.

Në kushte të krizës energjetike, interesi për centralet diellore dhe të erës është intensifikuar në dy vitet e fundit. Legjislacioni kombëtar për zhvillimin e BRE-ve nuk ka kujdes të veçantë për vlerat e habitateve dhe specieve (përveç nga aspekti i klasës së tokës bujqësore), që kanë rezultuar në lëshimin e lejeve dhe ndërtimin e centraleve fotovoltaike në habitatet prioritare të tilla si tokat e kripura. Për këtë qëllim është bërë analizë e detajuar [analiza për shfrytëzimin e sipërfaqe të degraduara dhe të papërdorshme](#) si lokacione për centrale diellore dhe të erës në Maqedoninë e Veriut[1], si dhe gjithashtu u krijua një hartë interaktive¹⁶ ku vendet e përshtatshme janë të theksuara qartë. Rezultatet tregojnë se në rreth 14500 hektarë tokë të degraduar mund të prodhohen 11 gigavat energji diellore, ndërsa në rreth 3500 hektarë mund të prodhohen 354 megavat energji të erës, e cila paraqet një bazë solide për zhvillimin e planeve energjetike që janë në linjë me synime kombëtare. Kjo qasje bën të mundur gjetjen e një ekuilibri midis nevojës në rritje për energji elektrike dhe ruajtjes së biodiversitetit të pasur të vendit.

[1] Studimi është bërë nga “The Nature Conservancy”, “Eko-Svest” dhe ASHAM, ndërsa ISHMJ-ja ka ofruar të dhënat hapësinore për sa i përket biodiversitetit.

Forcimi i kapaciteteve për ruajtjen e natyrës

Në kuadër të projektit IPA 2 për përmirësimin e kapaciteteve për Natura 2000 dhe CITES në vitin 2023, u hartua trajnimi për zbatimin e Rregullores për tregtinë e specieve të rrezikuara të kafshëve dhe bimëve në përputhje me nevojat në nivel kombëtar dhe 10 modulet e planifikuara, 3 janë realizuar përmes të cilave mbulohen të gjitha palët kyçe (MMJPH, MBPU, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Drejtoria Doganore, ISHMJ, Instituti Veterinar, etj). Gjithashtu, për zbatimin e Direktivave për shpendët dhe habitatet është projektuar një trajnim me 10 module, nga të cilat 8 janë zbatuar me pjesëmarrjen e palëve kryesore. Për të gjitha trajnimet u siguruan ekspertë ndërkombëtarë të cilët ndanë përvojat e tyre në zbatimin e direktivave përkatëse dhe krijimin e rrjetit Natura 2000.

Për skaj trajnimeve të shumta lidhur me zbatimin e Direktivave për shpendët dhe habitatet, tema që lidhet me krijimin e zonave Natura 2000, detyrimet dhe përfitimet, përfshirjen e tyre në planet zhvillimore, si dhe menaxhimin e ardhshëm ende nuk dihet mjaftueshëm, veçanërisht në nivel lokal. Në kuadër të programit zviceran për ruajtjen e natyrës në Maqedoni, u organizua një fushatë e synuar për Natura 2000 për popullatën dhe palët e interesuara në Rajonin Planor Lindor në disa faza përmes mediave rajonale dhe lokale. Matja e nivelit të ndërgjegjësimit të popullatës vendase ka shënuar rritje, por rekomandimi kryesor për të arritur një rezultat më të mirë ishte se është e nevojshme të kryhen fushata të tilla në disa cikle gjatë vitit me mjetet e duhura. Një rekomandim tjetër është që ky model i suksesshëm duhet të përsëritet në nivel kombëtar për popullatën e përgjithshme dhe palët e interesuara.

Në nivel kombëtar, kapacitetet për zbatimin e legjislacionit të BE-së për natyrën janë të pamjaftueshme - Departamenti i Natyrës në MMJPH ka gjithsej 15 punonjës të cilët kryejnë punë administrative dhe profesionale në lidhje me zonat e mbrojtura, mbrojtjen e specieve, zonat Natura 2000, zbatimin e konventave ndërkombëtare, etj.

17 <https://inc.maps.arcgis.com/apps/instant/media/index.html?appid=42942e8407c246cabcb43a0259ac54fb>

Sa i përket menaxhimit të zonave të mbrojtura, administratat e parqeve kombëtare, NP Pyjet Kombëtare si menaxher i dy zonave të reja të mbrojtura Malet e Osogovës dhe Maleshevës dhe disa komuna si Resnja, Vevçani kanë njohuri të mira për nevojat dhe përfitimet e zonës së mbrojtur, tashmë kanë përgatitur plane menaxhuese dhe kanë ndërmarrë aktivitete për forcimin e kapaciteteve në bashkëpunim me institucionet shkencore, OJQ-të e konservimit dhe me mbështetjen e donatorëve të huaj (megjithatë, ka nevojë për mbështetje afatgjate nga institucionet kompetente me burime të përshtatshme financiare). Komunitatet e tjera që janë përgjegjëse për menaxhimin e një zone të mbrojtur ose kanë një zonë të mbrojtur në territorin e tyre kanë kapacitete shumë të dobëta menaxhuese (përfshirë zhvillimin e një plan menaxhimi) dhe mungesë financiare, megjithëse në përgjithësi janë të vetëdijshëm se zona e mbrojtur mund të jetë e dobishme për ta, kryesisht lidhur me rritjen e të ardhurave nga zhvillimi i turizmit (që duhet të jetë i qëndrueshëm), por vetëm pas zgjidhjes së problemeve me mbetjet dhe ujërat e zeza. Komuna e Makedonski Brodit ia ka bartur përgjegjësinë për menaxhimin e MN "Slatinski Izvor" te OJQ-ja Ursus Speleos, por po ashtu ballafaqohen me mungesë të kuadrit profesional dhe financiare që të mund të krijojnë një plan menaxhues dhe të monitorojnë zbatimin e tij. Autoriteti për të menaxhuar MN Kuklicë-Kratovë është i paqartë, i transferuar te OJQ-ja Izvor-Kratovo ose Muzeu i Kratovës, të dyja me kapacitete dhe burime të pamjaftueshme për menaxhim, edhe pse OJQ Izvor për shumë vite është kujdesur për mirëmbajtjen e Info Qendrës, pastrimi i mbetjeve, mirëmbajtja e gardhit, parkimi i vizitorëve etj.

Financimi i mbrojtjes së natyrës

Në fakt, mungesa e financimit të zonave të mbrojtura nga Buxheti i RSM-së, tregohet si problemi kryesor për funksionimin e menaxherëve dhe ruajtjen adekuate të zonave. Subjektet menaxhuese të ZM-së konsiderojnë se është e nevojshme mbështetja e vazhdueshme; fusha të caktuara nuk duhet të kenë përparësi ndaj të tjerave. Nëse ndahen mjete, ato duhet të ndahen proporcionalisht ose në përqindje, për të gjitha zonat e mbrojtura. Në Buxhetin e MMJPH-së për vitin 2023, gjithsej 16320000 denarë janë ndarë për sektorin e natyrës, prej të cilave 7050000 denarë për shërbime kontraktuale dhe 9000000 denarë për grante kapitale dhe shërbime kontraktuale për ndërmarrje dhe organizata joqeveritare. Përmes Programit për investime në mjedis për vitin 2023 (Gazeta zyrtare e RSM nr. 27/2023, e miratuar më 08.02.2023) janë ndarë 5.000.000,00 denarë për mbështetje të masave dhe aktiviteteve për mbrojtjen dhe promovimin e natyrës në R. Maqedonisë së Veriut.

7.3 Rekomandime për përmirësim

Rekomandimet për përmirësimin e situatës me ruajtjen e natyrës si dhe zbatimin e legjislacionit janë dhënë tashmë në raportin e parë në hije dhe janë zgjeruar në të dytin për vitin 2022. Këtë vit po analizojmë se cilat rekomandime janë zbatuar nga shteti dhe komunitatet.

Nr.	Rekomandime për harmonizimin e legjislacionit	Zbatimi i rekomandimit
1	Të miratohet ligj i ri për mbrojtjen e natyrës dhe aktet nënligjore përkatëse	I përpiluar në vitin 2016, ende i pa miratuar (në proces të harmonizimit ndërinstitucional)
2	Të miratohet Ligji i hartuar për lëvizjen dhe tregtinë ndërkufitare të specieve të egra dhe aktet nënligjore përkatëse	Po punohet intensivisht për korrigjimet e fundit sipas komenteve të Sekretariatit të CITES
3	Të rishikohet Ligji për Kullotat duke përfshirë aspektin e mbrojtjes së habitateve të rëndësishme të barit në kullota	Ndryshimet e bëra në ligj nuk plotësonin kërkesat për ruajtjen e habitateve të rëndësishme të barit në kullota.
4	Rekomandimet nga Direktiva për Zogjtë duhet të përfshihen plotësisht në Ligjin e ri për Kafshët e Egra dhe Gjuetinë	Është e nevojshme të ndryshohet në mënyrë që të harmonizohen periudhat e gjuetisë për disa lloje shpendësh nga Aneksi 1 i Direktivës për Zogjtë.
5	Të finalizohet dhe miratohet Ligji për Planifikim Hapësinor në të cilin është inkorporuar koncepti i infrastrukturës së gjelbër	Teksti i ligjit është duke u finalizuar
6	Të intensifikohet hartimi i Ligjit për Tokat	Në kuadër të GEF STAR6 ka filluar hartimi i ligjit
7	Të fillojë zhvillimi i masave agroekologjike (nëpërmjet programit IPARD III) që do të marrin parasysh edhe zonat e Natura 2000	Nuk ka progres
	Rekomandime për zbatimin e legjislacionit	Zbatimi i rekomandimit
1	Për të vazhduar me identifikimin e zonave të propozuara Natura 2000	Edhe pse po punohet intensivisht në 21+4 zonat e propozuara, është e nevojshme të vazhdohet procesi i mbledhjes së të dhënave dhe propozimit të zonave të reja për speciet dhe habitatet që nuk mbulohen në këtë fazë.
2	Në periudhën nga identifikimi deri në shpalljen e zonave Natura 2000 në vend, aktivitetet infrastrukturore brenda dhe rreth zonave potenciale të Natura 2000 duhet të kufizohen për të parandaluar degradimin/shkatërrimin e habitateve të rëndësishme evropiane	Harta e përgatitur me lokacione të favorshme për centralet me erë dhe diellore nuk merret parasysh gjatë dhënies së lejes së ndërtimit.
3	Të vendoset bashkëpunimi ndërinstitucional (sidomos MMJPH, MBPU, ME dhe ndërmarrjet publike për pyjet dhe kullotat) tashmë në proces të identifikimit të zonave të Natura 2000 për të krijuar një propozim të përshtatshëm që do t'i paraqitet Komisionit Evropian, por edhe në mënyrë që të hartohen masat e duhura për menaxhim që do të duhet të zbatohen në ato fusha në të ardhmen	Inicuar në kuadër të projektit IPA2 Natura 2000

4	Të zbatohet procedura për rishpalljen e PK "Mavrovë", pas së cilës do të hartohet Plani i Menaxhimit dhe Plani Hapësinor për parkun.	Studimi i përgatitur për rivlerësimin me zonimin e Parkut
5	Të përshpejtohet procesi i rivlerësimit dhe rishpalljes së të gjitha zonave të mbrojtura të deklaruara para miratimit të Ligjit për Natyrën në vitin 2004, i cili parashikonte detyrimin për kryerjen e rivlerësimit dhe përgatitjen e akteve të reja për shpallje brenda gjashtë viteve.	Megjithëse janë përgatitur projektligje për disa fusha (p.sh. Matka) ose studime rivalorizimi (p.sh. Tikvesh, Balta e Katlanovës, etj.), procedurat nuk kanë filluar ose nuk janë finalizuar.
6	Për të përshpejtuar procesin e shpalljes së zonave të reja të mbrojtura për të cilat janë përgatitur ose janë në zhvillim e sipër studime për valorizim/ligje.	Është në proces deklarimi i Baltës së Studencistës dhe Belçishtës. Për Jabllanicën po punohet për plotësimin e studimit të valorizimit.
7	Të miratojë plane menaxhimi (PM) për të gjitha zonat e mbrojtura që kanë një subjekt të caktuar menaxhues	Në proces, por zbatimi ecën ngadalë: <ul style="list-style-type: none"> - PM për MN "Liqeni i Prespës" pret për miratim) - PM për PK "Mavrovë" draft plani i përgatitur nuk është miratuar dhe duhet të rishikohet tërësisht sipas gjetjeve të Studimit të rivalorizimit të përgatitur - Draft PM për MN "Matka" është bërë më shumë se 10 vjet më parë dhe nuk është miratuar, është i vjetëruar. - PM për MN "Ezerani" është tejkualuar dhe duhet të revidohet nga ana e menaxhuesit – Komuna e Resnjës - zonat e tjera të deklaruara nuk kanë plane menaxhuese të zhvilluara p.sh.: MN Slatinski Izvor, MN Ujërave të Smolarës, MN Markovi Kuli, MN Kuklici, Kratovë, MN Lokvi Golemo Konjare, MN Tikvesh, MN Balta e Katlanovës, etj.
8	Të përditësohet Plani Kombëtar i Veprimit për ruajtjen e rrëqebullit të Ballkanit	I planifikuar për vitin 2024
9	Për të përshpejtuar zbatimin e Rekomandimit nr. 211 i vitit 2021 nga Komiteti i Përhershëm i Konventës së Bernës lidhur me çështjen e hapur të vitit 2013 "PK Mavrovë dhe hidroprojektet e planifikuara në territorin e tij" si dhe çështjen e hapur për dy zonat Emerald – MN "Liqeni i Ohrit" dhe PK "Galiçica"	Në proces, pjesërisht
10	Për të përshpejtuar zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të UNESCO-s për rajonin e Ohrit (në gusht 2021 u dha një periudhë shtesë prej dy vitesh për zbatimin e tyre), veçanërisht në fushën e objekteve të infrastrukturës.	Në proces

11	Të vazhdohet me përgatitjen e listave të kuqe të specieve të prekura për grupet taksonomike që nuk janë përfshirë në vitet e kaluara.	Nuk janë siguruar burime financiare
12	Zhvillimi i zonave për ruajtjen e lidhjes ndërmjet zonave të mbrojtura (korridoret ekologjike) dhe të fillohet me përcaktimit e masave të duhura për menaxhimin e tyre.	Janë zhvilluar dy udhëzime për menaxhimin e korridoreve ekologjike
13	Të krijohet një sistem kombëtar informacioni për natyrën dhe ta lidh atë me sisteme të tjera të tilla informacioni (për pyjet, tokat, ujërat, etj.)	Pritet të zhvillohet në kuadër të projektit IPA 2 për H2000/CITES
14	Të krijohet një listë të specieve invazive (nga të gjitha grupet taksonomike) me një hartë të shpërndarjes në nivel kombëtar dhe të propozojë masa për të reduktuar ose parandaluar shpërndarjen dhe zgjerimin e tyre.	Nuk ka progres
15	Të krijohet një qendër për kujdesin e kafshëve të egra për të cilat tashmë është përgatitur një studim fizibiliteti dhe deri në themelimin e saj të zhvillohet një procedurë për kujdesin e përkohshëm të individëve të specieve prioritare për mbrojtje.	Është iniciuar çështja e krijimit të një qendre të tillë në kuadër të projektit IPA2 Natura2000/CITES
16	Të vazhdohet me masat për izolimin e infrastrukturës së rrezikshme elektrike në bashkëpunim me EVN dhe MEPSO	Nuk ka progres
17	Aksionet e pyllëzimit të kryhen në bashkëpunim me institucionet kompetente dhe institucionet shkencore për të përzgjedhur speciet përkatëse autoktone.	Pjesërisht
18	Të inkorporohen masat e menaxhimit të pyjeve me vlerë të lartë natyrore në planet e menaxhimit të pyjeve	Nuk ka progres
19	Krijimi i një regjistri të kullotave dhe harmonizimi i menaxhimit të kullotave në zonat e mbrojtura	Nuk ka progres
20	Të merren masa për ruajtjen e praktikave tradicionale në blegtori	Nuk ka progres
21	Koncepti i shërbimeve të ekosistemit duhet të integrohet dhe zbatohet praktikisht të paktën në disa sektorë ku ka kushte bazë (për shembull menaxhimi i pyjeve dhe më tej, i kullotave). Skema e pagesave të ESU duhet të testohet në disa bashki më të vogla, veçanërisht ato pranë një zone të mbrojtur. Kjo është e rëndësishme sepse mund të sigurojë të ardhura shtesë për menaxhimin e zonave të mbrojtura.	Тестирана ПЕС-схема во општина Вевчани како дел од Швајцарската програма за зачувување на природата во Северна Македонија

22	Të inkurajohet zbatimi i agroturizmit (nëpërmjet praktikave tradicionale të kultivimit të varieteteve dhe racave lokale) dhe formave të tjera të ekoturizmit.	Promovuar në Rajonin Planor Lindor në kuadër të programit zviceran për ruajtjen e natyrës në Maqedoninë e Veriut
23	Krijimi i një Fondi të Mjedisit Jetësor/Natyrës është ende i rëndësishëm sepse mund të sigurojë financimin e pjeshëm të zonave të mbrojtura dhe zbatimin e masave të tjera për ruajtjen e natyrës.	Nuk ka vullnet politik
24	Futja e mekanizmave inovativë të financimit për zonat e mbrojtura (përfshirë skemën e PES) mund të ndihmojë në sigurimin e fondeve të nevojshme për zbatimin e planeve të menaxhimit.	Skema PES u zbatua në S.P. Burimet e Vevçanit.
25	Në mungesë të një Fondi të Mjedisit Jetësor, të gjitha zonat e mbrojtura duhet të mbështeten përmes Programit të Investimeve, jo vetëm nga parqet kombëtare.	Nuk ka progres

8

Ndryshimet klimatike



8 Ndryshimet klimatike

8.1 Pasqyrë për progresit në nënkapitullin 2023

Në vitin e kaluar, janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt harmonizimit me legjislacionin e ndryshimeve klimatike dhe arritjes së objektivave të ndryshimeve klimatike nga strategjia e miratuar afatgjate për ndryshimet klimatike. **Ka përfunduar procesi i hartimit të tekstit të projektligjit për veprimin klimatik** nga MMJPH në fund të vitit 2022, pas së cilës u organizua një takim me ministrinë me kërkesë të organizatave të shoqërisë civile për të mundësuar komentet e hershme për projektligjin. Në takim, këshilltari shtetëror për ndryshimet klimatike prezantoi projektligjin dhe afatin kohor të planifikuar, të ndjekur nga komentet dhe diskutimet kryesore. Në periudhën janar-mars, Ministria organizoi takime pune me të gjitha palët e interesuara për prezantimin e projektligjit dhe konsultimin e hershëm të tekstit. Në muajin mars u organizua një takim pune ndërmjet organizatave të shoqërisë civile – anëtarë të Koalicionit Kombëtar për Veprim Klimatik në sektorin e ndryshimeve klimatike dhe këshilltarit shtetëror për ndryshimet klimatike, ku u ndërhyrë drejtpërdrejt në projektligjin për veprimin klimatik. Pas diskutimit publik të organizuar nga MMJPH-ja më 23.03.2023, ku ishin ftuar dhe morën pjesë të gjitha palët e interesuara, koalicioni klimatik i organizatave të shoqërisë civile dërgoi komente për projektligjin për veprimin klimatik më 27.03.2023. Projektligji për Veprimin Klimatik është në sekretariatit e legjislacionit deri në përfundimin e raportit në hije (mars 2023).

Raporti i BE-së për progresin në sektorin e klimës disa vite më radhë e më parë e vë në dukje këtë që **është e nevojshme të zbatohet Marrëveshja e Parisit**, për të miratuar ligjin e veprimin klimatik dhe Planin Kombëtar të Përshtatjes si politikat dhe ligjet kryesore që përcaktojnë kuadrin e veprimit për klimën të vendit. Edhe pse ligji i veprimit për klimën është duke u krijuar për më shumë se pesë vjet, **ende nuk është miratuar.**

Në versionin e fundit të publikuar të tekstit të projektligjit për veprimin klimatik, legjislacioni vendas është harmonizuar me rregulloret e BE-së që e rregullojnë atë **mekanizëm të monitorimit dhe raportimit** dhe për herë të parë legjislacioni kombëtar përshkruan përgjegjësitë dhe rregullat për monitorimin dhe raportimin e emetimeve të gazrave serrë, si dhe harmonizimin e pjesshëm me rregulloret e sistemit të tregtimit të emetimeve (EU ETS). Përcaktimi i një mekanizmi kombëtar për monitorimin dhe raportimin është shumë i rëndësishëm sepse krijon një ndarje të qartë të roleve dhe përgjegjësive në institucioneve në nivel institucional dhe komunal për detyrimin për mbledhjen e të dhënave dhe përgatitjen e një inventari vjetor të gazrave serrë.

Me Projektligjin gjithashtu përcaktohet edhe **taksa e karbonit** si një mekanizëm për përshpejtimin e tranzicionit energjetik, por edhe financimin e masave të veprimit klimatik. Prezantimi i kësaj mase dërgon një sinjal të qartë për sektorët intensiv të karbonit se ata duhet të fillojnë kalimin në teknologji të pastra dhe për qytetarët që si ndotësit e mëdhenj ashtu edhe personat fizikë ndajnë të njëjtat detyrime për të arritur qëllimet klimatike.

Mekanizmi Koordinues Kombëtar për Veprimin Klimatik të përcaktuara në projektligjin për veprimin klimatik që duhet të sigurojë transparencë në zbatimin e ardhshëm të politikave dhe masave të veprimit klimatik.

8.2 Zbatimi i legjislacionit

2019

2019-Hartimi i strategjisë së energjisë përfshin konsultimin me palët e interesuara, OSHC-të e përfshira

Qeveria e RMV-së e miraton Strategjinë Kombëtare të Energjetike, **Faza e përjashtimit të qymyrit TC Osllomej 2019- TC Bitola 2025-2028**

Strategjia e energjetikës

2020

Tranzicioni i energjisë në Osllomej
120 MW impiante solare në vend të ish minierës së qymyrit në TC Osllomej

4-ti Plan Kombëtar Klimatik dhe 3-ti Raport klimatik për UNFCCC **eNDCs2021**

Raportimi ne UNFCCC

NECP

Grupet e punës NECP përfshijnë të gjitha palët e interesuara – autoritetet lokale dhe kombëtare, entitetet private, OSHC-të, objektivi i BRE-ve -38% deri në vitin 2030 qymyri do të largohet nga programi JT deri në vitin 2028

Ligjet për veprim klimatik dhe strategjia

Strategjinë Kombëtare të Energjetike e miratuar 2021; Propozim Ligji për veprim klimatik të miratohet më 2024.

2021-2023

2023 ACT IP

Mbështet programin Tranzicioni i drejtë. Projekte dhe procese të paqarta

Propozim Ligji për Energjinë;

Propozim Ligji për IAP-në

Procesi ka filluar në dhjetor 2023

Projektligji i Veprimit Klimatik është i rëndësishëm pasi përmban një objektiv klimatik dhe ripohon angazhimin nga Marrëveshja e Parisit për të kufizuar ngrohjen globale nën 1.5 gradë Celsius si dhe mbështetjen e përpjekjeve për **Evropën neutrale ndaj klimës deri në vitin 2050**. Me këtë dispozitë, angazhimet nga strategjia afatgjate e veprimit për klimën dhe kontributet e rishikuara në ndryshimet klimatike për të ulur në zero emetimet e gazeve serrë të vendit deri në vitin 2050 bëhen detyrim ligjor i shtetit.

Zbatimi i mekanizmit të monitorimit dhe raportimit është një sfidë e madhe për shtetin, veçanërisht sepse situata aktuale është e tillë **zgjidhja softuerike për MRV** që është në kompetencë të Agjencisë së Energjisë në përgjithësi **nuk mbahet dhe nuk ka staf profesional** të punësuar në agjenci që e njeh këtë softuer. Stafi profesional me njohuri për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për emetimet e gazeve serrë mungon në MMJPH-jë si dhe në institucione të tjera me detyrime që do të dalin nga dispozitat për monitorimin dhe raportimin.

Taksa e karbonit si një mekanizëm për sigurimin e mbështetjes financiare për masat e veprimit klimatik do të jetë efektive vetëm nëse fondet derdhen në një **fond për mjedisin jetësor** ose në mungesë të fondit – **në buxhet të MMJPH-së** si një institucion përgjegjës për zbatimin e planeve dhe ligjeve për ndryshimet klimatike dhe që mund të njohë masat financuese prioritare për arritjen e synimeve të përcaktuara klimatike.

Mekanizmi Kombëtar Koordinues për Veprimin Klimatik i cili është përcaktuar në projektligjin për veprimin klimatik mund të njihet si trup pune për **mbikëqyrjen e funksionimit të fondeve** mbi financimin e masave të veprimit klimatik dhe një forum për diskutimin e masave aktuale dhe të ardhshme të veprimit klimatik në të gjithë sektorët.

Tabela 4: Vështrim i përgjithshëm i dekarbonizimit dhe objektivave të përbashkëta të BRE-ve të strategjive kryesore të energjisë

Strategjitë (qëllimet)	Qëllimi i parashikuar i dekarbonizimit	Pjesa e parashikuar e BRE-ve:
PKKE (2030)	82% 61,5% reduktim të neto emetimit të GS krahasuar me 1990	38% pjesë e burimeve të rinovueshme në konsumin përfundimtar bruto të energjisë
Strategjia energjetike (skenari i gjelbër, 2040)	61,5% reduktim të neto emetimit të GS krahasuar me 2005	45% pjesë e burimeve të rinovueshme në konsumin përfundimtar bruto të energjisë
Strategjia afatgjate për veprimin klimatik (2050)	72% reduktim të neto emetimit të GS krahasuar me nivelet më 1990	49% pjesë e burimeve të rinovueshme në konsumin përfundimtar bruto të energjisë

Burimi (Qeveria e Maqedonisë së Veriut 2019b, 2022)

Aktualisht, janë duke u ndjekur të gjitha dokumentet planifikuese dhe strategjike në fushën e energjisë dhe ndryshimeve klimatike, **të njëjtat synime afatgjata për uljen e emetimeve të gazeve serrë me më shumë se gjysmën deri në vitin 2030**, përmes dekarbonizimit në radhë të parë të sektorit të energjisë, por edhe rritjes së pjesëmarrjes së burimeve të rinovueshme të energjisë. Projektligji për Burimet e Rinovueshme të Energjisë **nuk ka një objektiv të qartë për BRE**, në vend të kësaj duke

iu referuar dokumenteve kombëtare dhe strategjike në fushën e energjisë. Një problem në zbatimin e legjislacionit për klimën është se asnjë nga këto dokumente planifikuese dhe strategjike **nuk pasqyrojnë se cili do të jetë ndikimi i planeve të gazifikimit të vendit ndaj emetimeve gazrave serrë dhe nëse këto plane do të parandalojnë reduktimin e parashikuar të emetimeve të gazeve serrë me më shumë se gjysmën deri në vitin 2030.**

Me projektligjin për energjinë, **Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës rregullohet me kornizë ligjore** si një dokument strategjik që miratohet çdo 10 vjet me një projeksion për 20 vjet shtesë. Kontributet kombëtare për veprimin klimatik ende nuk kanë kornizë ligjore në legjislacionin ekzistues.

Në konferencën e 28-të për klimën në Konventën Kuadër të OKB-së për Klimën, Qeveria e prezantoi **Planin e investimeve për tranzicionin e përsheptuar të energjisë (CIF ACT IP)** e cila duhet të shërbejë si masë për të mbështetur zbatimin e **Programit për Tranzicion** të Drejtë nga Plani i Energjisë dhe Klimës. Plani i investimeve është një lloj plani strategjik që propozon zona në të cilat mund të investohet për qëllime të një tranzicioni të përsheptuar nga qymyri dhe zona në të cilat është e nevojshme të ndërhyhet me mbështetje teknike, dhe në të njëjtën kohë është një platformë për sigurimin ose tërheqjen e bashkëfinancimit nga burime financiare dypalëshe, shumëpalëshe dhe private. Plani i investimeve është miratuar, me draft raportin për vlerësimin strategjik të mjedisit të paraqitur pas miratimit të planit të investimit, i cili përmban komponentë, ndërsa specifikon projektet që duhet të bëhen në periudhën e ardhshme.

Komponentët e planit të investimit	Bankat e Zhvillimit Shumëpalëshe (IMDB)	Pjesa e IMDB	CIF ACT	Sektori privat	Qeveria/ NP /të tjerë	Total	Shtyllat		
							Infrastruktura	Njerëzit	Menaxhimi
PROEKT 1: SHINDËRRIMI I TERMOCENTRALEVE DHE ZËVENDËSIMI I KAPACITETIT TË QYMYRIT ME BURIME TË RINOVUESHME TË ENERGJISË									
A: Shndërrimi i termocentraleve, rehabilitimi dhe shndërrimi i minierave	WB, EBRD	110	(c) 25 (g) 0.5		35	170.5	V		V
B: Perspektiva: burime të reja të rinovueshme të energjisë në zonat e prekura nga qymyri	EBRD, IFC	230	(g) 1.8	75		306.8	V	V	V
C: PowerHub: forcimi i rrjetit, bateritë, trajnimi për të ardhmen	EBRD, IFC, WB	75	(c) 27 (g) 2.5	10		114.5	V	V	
PROEKT 2: RIGJENERIMI SOCIO-EKONOMIK I RAJONIT TË PELLAGONISË DHE JUGPERËNDIMOR									
A: Programi i Gjelbër dhe Britje (Green & Growth) – për SME-të	EBRD	5.3	(c) 2.7 (g) 1.95			9.95	V	V	
B: Revitalizo (Revitalise): rigjenerimi ekonomik i zonave industriale	EBRD, WB	10	(c) 5.5 (g) 0.5			16	V	V	V
C: Programi i zgjuar klimatik për rigjenerimin ekonomik	EBRD, IFC	22	(c) 2.7 (g) 0.65			25.35		V	
PROEKT 3: EFIKASITETI I ENERGJETIK (EE), NXEHTËSIA E PASTËR DHE PRODHIMI I DECENTRALIZUAR I ENERGJISË									
A: Ekobust (ECOBOOST)Fuqizimi i komuniteteve në rajonet e qymyrit me alternativa efikase të rinovueshme	EBRD	8	(c) 5.6			13.6	V	V	
B: EkoKomuna (EcoCommune) Iniciativa për komunitetet të energjisë së pastër	WB	11	(c) 8 (g) 0.6			19.6	V	V	
Plani i investimit / Total		471.3	(c) 76.5 (g) 8.5	85	35	676.3			

Projektet specifike në këtë dokument si dhe zbatimi i tyre duhet të zgjidhen sipas **strukturën organizative nga Udhërrëfyesi për Tranzicion të Drejtë** miratuar me vendim të Qeverisë në vitin e kaluar. Sipas kësaj strukture organizative, bashkësitë lokale në rajonin e Kërçovës dhe Manastirit, si rajone me thëngjill, duhet të marrin pjesë aktive në procesin e vendimmarrjes përmes **forumeve të komunitetit**.

Udhërrëfyesi për tranzicion të drejtë – struktura organizative (sipas Vendimit të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut nga 13 qershori 2023)

<p>Ministri i Ekonomisë – Koordinator nacional për zbatimin e Udhërrëfyesit për tranzicion të drejtë</p> <p>Ministria e Ekonomisë- grupet e punës të formuara për:</p> <p>↳ Rikualifikim dhe trajnim</p> <p>↳ Tranzicioni ekonomik</p> <p>↳ Energjia e rinovueshme dhe depozitimi</p>	<p>Këshilli për tranzicion të drejtë:</p> <p>Ministri i Ekonomisë – bashe kryesues;</p> <p>Ministri i financave</p> <p>Ministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor</p> <p>Ministri i Punës dhe Politikës Sociale</p> <p>Ministri i Transportit</p> <p>Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizmit me Ujërat</p> <p>Ministri për Vetë- qeverisje lokale</p> <p>Ministri i Shkencës; Drejtori i ESM</p> <p>Drejtori i MEPSO</p> <p>Drejtori i NOMAGAS</p> <p>Rekomandohet që BNJVL-ja të formojë forume rajonale për tranzicion të drejtë në Kërçovë dhe Manastir.</p>
--	--

Sfidat

Problemi më i madh për arritjen e synimeve të deklaruara klimatike të shtetit është fakti se **Ligji për Veprimin Klimatik dhe Plani Kombëtar i Përshtatjes ende mungojnë**. Këto dokumente duhet të japin udhëzime bazë për rolet e nivelit institucional dhe vendor në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në vend, por edhe për të përmirësuar komunikimin dhe koordinimin ndërmjet institucioneve dhe me vetëqeverisjen lokale në drejtim të zbatimit të masave të veprimit klimatik.

Praktika e **miratimit të dokumenteve strategjike dhe ligjeve me rëndësi për energjinë dhe ndryshimet klimatike në afate të shkurtra dhe gjatë festave** parandalon pjesëmarrjen substanciale të të gjitha palëve të interesuara në fazat e hershme të hartimit - proces përmes të cilit në të njëjtën kohë

të gjithë palët e interesuara informohen dhe edukohen rreth temës dhe kanë mundësinë të japin komente thelbësore që do të përmirësojnë tekstin dhe zbatimin e ardhshëm. Ndonëse në praktikë procedura për miratimin e ligjeve respektohet plotësisht, në realitet e gjithë procedura është e nxituar si në rastin e projektligjit për energjinë dhe projektligjit të ri për BRE të cilat u publikuan në ENER gjatë festave të Krishtlindjeve dhe nuk u parashikua konsultim më herët. Në të njëjtën kohë, praktika e miratimit të dokumenteve strategjike pa një vlerësim të ndikimit në mjedis po bëhet gjithnjë e më e zakonshme, si në shembullin e Planit të Energjisë dhe Klimës dhe Planit të Investimeve ose miratimit të VSM-së dhe VNM-së për projektet e energjisë elektrike që janë në praktikë të dëmshme ndaj mjedisit dhe komuniteteve lokale. Në mënyrë që të shmangët kjo praktikë, **harta e vendndodhjeve për ndërtimin e centraleve fotovoltaike dhe të erës** në bazë të kriterëve të përcaktuara duhet të merret parasysh gjatë përgatitjes së planit vjetor për ndërtimin e objekteve energjetike, si dhe të integrohet në planin e ri hapësinor që po përgatitet.

Gjendja e PKEK-ve në Ballkanin Perëndimor	Draft PKEK të dorëzuara në Komunitetin Energjetik	Konsultimi publik	Ka vlerësim strategjik të mjedisit jetësor që është përpiluar për PKEK-të	Rezultatet nga konsultimet publike janë publikuar	Vlerësimi nga Komuniteti Energjetik
Shqipëria					
B&H					N/A
Kosova					N/A
Mali i Zi					N/A
Maqedonia e Veriut					
Serbia					

Mungon **informimi dhe edukimi** i komunave për masat e veprimit klimatik, por edhe të institucioneve të tjera përkatëse dhe qytetarëve, gjë që vështirëson zbatimin e planeve dhe ligjeve strategjike nga sektorët e energjisë dhe ndryshimeve klimatike.

<p>Transparencë në miratimin dhe zbatimin e politikave klimatike</p>	<p>Pjesërisht e realizuar</p>	<p>Miratimi i politikave klimatike duhet të kryhet në mënyrë transparente, duke siguruar një periudhë mjaftueshëm të gjatë kohore për zbatimin e këtyre proceseve dhe informacion adekuat për publikun duke përfshirë të gjithë aktorët në të gjitha politikat sektoriale me rëndësi për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike</p>
<p>Veprimi klimatik duhet të jetë një prioriteti të lartë për vendin</p>	<p>E parealizuar</p>	<p>Masat për arritjen e qëllimeve klimatike duhet të jenë të pranishme në të gjitha politikat klimatike.</p> <p>Sipas Strategjisë Afatgjate të Veprimit Klimatik, politika klimatike janë edhe ato që kryhen në sektorët e energjisë, planifikimit hapësinor, mbeturinave, transportit, bujqësisë dhe zhvillimit rural, shëndetësisë dhe natyrës.</p>

9

Financimi



9 Financimi

Financimi i masave dhe aktiviteteve për përmirësimin e mjedisit jetësor ende mungon. Mjetet e akorduara nga shteti për MMJPH-në janë minimale (0.69%) është përqindja e buxhetit për këtë ministri në raport me buxhetin total të shtetit. Transferet e fondeve shtesë nga të cilat mund të financohen projektet për mbrojtjen e mjedisit jetësor janë të kufizuara. Nuk ka pothuajse asnjë program të rregullt dhe të dedikuar për financimin e projekteve për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Herë pas here bëhen thirrje për të subvencionuar një pjesë të kostove të kondicionerëve, pajisjeve të gazit në makina etj., por këto janë aktivitete të ministrive dhe zakonisht janë në përmasa të vogla. Në vijim në tabelë jepen buxheti total i shtetit dhe buxheti total i MMJPH-së për vitin 2023 dhe ai i planifikuar për vitin 2024.

Përshkrimi	2023 në mijë denarë		2024 në mijë denarë	
Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut	376,924,641		388,691,113	
Shpenzimet për përdorues buxhetor				
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor	1,868,040	0.50%	2,676,990	0.69%
Shpenzimet sipas funksioneve buxhetore				
Mbrojtja e mjedisit jetësor	2,445,056	0.65%	3,217,995	0.83%

Në anën e shpenzimeve të buxhetit për vitin 2023 dhe 2024, transfertat e Ministrisë së Financave për shfrytëzuesit e buxhetit (ministritë, agjencitë, fondet dhe organet e tjera shtetërore) janë kryesisht për financimin e punës së tyre operacionale. Në këtë kontekst, transferimet bëhen edhe tek institucionet që kanë kompetenca në fushën e mjedisit, si Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Administrimit të Ujërave; Ministria e Ekonomisë, por kryesisht për funksionimin e tyre aktual.

Për sa i përket buxhetit sipas sektorëve të MMJPH-së, buxheti total i miratuar për vitin 2023 është ndarë në seksionet e mëposhtme¹⁸

Nr. rendor	Përshkrimi i pjesëve të buxhetit	Numri i zërit	Shuma maksimale
1.	Buxheti total i miratuar		1.868.040.000
2.	Pjesë e pashpërndarë e buxhetit		49.085.000
2.1	Mallrat dhe shërbimet	42	45.925.000
2.11	Shpenzime udhëtimi dhe ditore	420	6.000.000

¹⁸ Vendim për shpërndarjen e brendshme të buxhetit total të miratuar për vitin 2023 të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

2.12	Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport	421	30.000.000
2.13	Materialet dhe inventari i imët	423	1.000.000
2.14	Riparime dhe mirëmbajtja e vazhdueshme	424	1.100.000
2.15	Shërbime kontraktuale	425	6.000.000
2.16	Shpenzime të tjera rrjedhëse	426	1.825.000
<u>2.2</u>	<u>Subvencione dhe transferta</u>	<u>46</u>	<u>600.000</u>
2.21	Transferta të ndryshme	464	1.825.000
<u>2.3</u>	<u>Shpenzime kapitale</u>	<u>48</u>	<u>2.560.000</u>
2.31	Blerja e pajisjeve dhe makinerive	480	160.000
2.32	Objekte ndërtimi	481	2.000.000
2.33	Blerja e mobiljeve	483	300.000
2.33	Investimet dhe asetet jofinanciare	485	100.000
3.	Buxheti i destinuar për shpenzimet e përbashkëta të subjektit		120.948.000
<u>3.1</u>	<u>Programi i pagave dhe kompensimeve</u>	<u>40</u>	<u>120.948.000</u>
3.2	Paga bazë	401	87.042.000
3.3	Kontributet e sigurimit social	402	33.786.000
3.4	Kompensime	404	120.000
4.	Buxheti i destinuar për zbatimin e politikave dhe projekteve		1.698.007.000
<u>4.1</u>	<u>Departamenti për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Investime</u>		<u>520.540.000</u>
4.10	Shpenzime udhëtimi dhe ditore	420	500.000
4.11	Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport	421	1.000.000
4.12	Materialet dhe inventari i imët	423	200.000
4.13	Riparimet dhe mirëmbajtja e vazhdueshme	424	100.000
4.14	Shërbimet kontraktuale	425	19.080.000
4.15	Shpenzime të tjera rrjedhëse	426	200.000
4.16	Transferet deri tek OJQ-të	463	0
4.17	Blerja e pajisjeve dhe makinerive	480	0
4.18	Objekte tjera ndërtimore	482	268.620.000
4.19	Blerja e mobiljeve	483	0

4.18	Investimet dhe asetet jofinanciare	485	0
4.19	Dotacionet kapitale për NJQV-të	488	230.840.000
<u>4.2</u>	<u>Departamenti i koordinimit të punës së ministrit</u>		<u>4.630.000</u>
4.20	Shpenzime udhëtimi dhe ditore	420	50.000
4.21	Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport	421	100.000
4.22	Materialet dhe inventari i imët	423	80.000
4.23	Riparimet dhe mirëmbajtja e vazhdueshme	424	100.000
4.24	Shërbimet kontraktuale	425	500.000
4.25	Shpenzime të tjera rrjedhëse	426	3.800.000
4.26	Transfere të ndryshme	464	0
4.27	Blerja e mobiljeve	483	0
<u>4.3</u>	<u>Spektori natyrë</u>		<u>16.320.000</u>
4.30	Mallrat dhe shërbimet		
4.31	Shpenzime udhëtimi dhe ditore	420	50.000
4.32	Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport	421	100.000
4.33	Materialet dhe inventari i imët	423	20.000
4.34	Riparime dhe mirëmbajtja e vazhdueshme	424	0
4.35	Shërbime kontraktuale	425	7.050.000
4.36	Shpenzime tjera rrjedhëse	426	100.000
4.37	Blerja e pajisjeve dhe makinerive	480	0
4.38	Objekte të tjera ndërtimore	482	0
4.39	Blerja e mobiljeve	483	0
4.391	Investimet dhe asetet jofinanciare	485	0
4.392	Dotacionet kapitale për ndërmarrjet dhe organizatat joqeveritare	489	9.000.000
<u>4.4</u>	<u>Spektori ujërat</u>		<u>396.082.000</u>
4.40	Shpenzime udhëtimi dhe ditore	420	50.000
4.41	Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport	421	5.390.000
4.42	Materialet dhe inventari i imët	423	300.000
4.43	Riparime dhe mirëmbajtja e vazhdueshme	424	400.000

4.44	Shërbime kontraktuale	425	8.100.000
4.45	Shpenzime tjera rrjedhëse	426	150.000
4.46		464	102.592.000
4.47	Blerja e pajisjeve dhe makinerive	480	5.600.000
4.48	Objekte të tjera ndërtimore	482	233.000.000
4.49	Blerja e mobiljeve	483	100.000
4.491	Dotacionet kapitale për ndërmarrjet dhe organizatat joqeveritare	489	40.400.000
4.5	<u>Sektori i mbeturinave</u>		<u>171.600.000</u>
4.51	Shërbimet kontraktuale	425	20.000.000
4.52	Shpenzime tjera rrjedhëse	426	100.000
4.53	Blerja e pajisjeve dhe makinerive	480	105.000.000
4.54	Objekte të tjera ndërtimore	482	44.000.000
4.55	Investimet dhe asetet jofinanciare	485	2.500.000
4.56	Dotacionet kapitale për ndërmarrjet dhe organizatat joqeveritare	489	0
4.6	<u>Sektori i Ndotjes Industriale dhe Menaxhimit të Rrezikut</u>		<u>42.420.000</u>
4.61	Shpenzime udhëtimi dhe ditore	420	100.000
4.62	Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport	421	85.000
4.63	Materialet dhe inventari i imët	423	90.000
4.64	Riparime dhe mirëmbajtja e vazhdueshme	424	600.000
4.65	Shërbime kontraktuale	425	12.190.000
4.66	Shpenzime tjera të vazhdueshme	426	55.000
4.67	Transfere të ndryshme	464	27.000.000
4.68	Blerja e pajisjeve dhe makinerive	480	2.300.000
4.69	Investimet dhe asetet jofinanciare	485	0
4.7	<u>Sektori i Mjedisit Jetësor</u>		<u>8.700.000</u>
4.71	Shpenzime udhëtimi dhe ditore	420	200.000
4.72	Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport	421	1.000.000
4.73	Materialet dhe inventari i imët	423	400.000
4.74	Riparime dhe mirëmbajtja e vazhdueshme	424	300.000
4.75	Shërbime kontraktuale	425	800.000

4.76	Shpenzime tjera rrjedhëse	426	400.000
4.77	Blerja e pajisjeve dhe makinerive	480	1.000.000
4.78	Objektet ndërtimore	481	4.300.000
4.79	Blerja e mobiljeve	483	0
4.791	Investimet dhe asetet jofinanciare	485	300.000
<u>4.8</u>	<u>ektori për planifikim hapësinor</u>		<u>57.145.000</u>
4.80	Shpenzime udhëtimi dhe ditore	420	50.000
4.81	Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport	421	0
4.82	Materialet dhe inventari i imët	423	120.000
4.83	Riparime dhe mirëmbajtja e vazhdueshme	424	125.000
4.84	Shërbimet kontraktuale	425	56.000.000
4.85	Blerja e pajisjeve dhe makinerive	480	350.000
4.86	Investimet dhe asetet jofinanciare	485	500.000
<u>4.9</u>	<u>Sektori Qendra Informative Maqedonisë për Mjedisin Jetësor</u>		<u>25.880.000</u>
4.91	Shpenzime udhëtimi dhe ditore	420	300.000
4.92	Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport	421	4.150.000
4.93	Materialet dhe inventari i imët	423	1.100.000
4.94	Riparime dhe mirëmbajtja e vazhdueshme	424	2.550.000
4.95	Shërbimet kontraktuale	425	3.600.000
4.96	Shpenzime të tjera rrjedhëse	426	480.000
4.97	Blerja e pajisjeve dhe makinerive	480	11.400.000
4.98	Objekte tjera ndërtimore	482	0
4.99	Blerja e mobiljeve	483	0
4.991	Investimet dhe asetet jofinanciare	485	2.300.000
<u>4.10</u>	<u>Sektori për BE-në</u>		<u>1.000.000</u>
4.101	Shpenzime udhëtimi dhe ditore	420	0
4.102	Shërbimet kontraktuale	425	1.000.000
4.103	Objekte tjera ndërtimore	482	0

4.11	Spektori për vetëqeverisje lokale		190.000
4.110	Shërbimet kontraktuale	425	100.000
4.111	Blerja e mobiljeve	483	90.000
4.112	Investimet dhe asetet jofinanciare	485	0
4.12	Spektori i Zbatimit të IPA-së		453.500.000
4.120	Objekte tjera ndërtimore	482	453.500.000

Me qëllim për verifikimin e mjeteve financiare në dispozicion në nivel lokal, sipas buxheteve të komunave, kemi analizuar buxhetet totale dhe fondet e destinuar për aktivitete në mjedisin jetësor. Në vijim është dhënë një pasqyrë e disa komunave, edhe pse me përjashtim të Qytetit të Shkupit, gjendja me mjetet e buxhetuara për mjedisin jetësor nuk dallon dukshëm për komunat tjera.

Komuna	Buxheti total për vitin 2023 (mkd)	Buxheti për mjedisin jetësor për vitin 2023 (mkd) R1	% pjesëmarrjes së mjedisit jetësor në totalin e buxhetit
Ohri	58,674,000	2,720,000	4,64
Struga	11,815,130,00	2,260,000	0,19
Manastiri	20,996,986,41	11,061,00	0,53
Debarca	126,520,050	-	0,00
Berova	370,603,000	80,000	0,02
Dojrani	363,395,000	-	0,00

9.1 Kapacitetet administrative

Aktualisht MMJPH ka 204 të punësuar¹⁹, të cilët shpërndahen nëpër sektorë si në vijim:

- ↳ Zëvendësministri
- ↳ Këshilltarë shtetërorë **3**
- ↳ Departamenti i Auditimit të Brendshëm **2**
- ↳ Spektori për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Planifikimin Strategjik **6**
- ↳ Spektori për çështjet juridike dhe të përgjithshme **11**
- ↳ Spektori për bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale dhe punët administrative-mbikëqyrëse **10**
- ↳ Spektori për Bashkimin Evropian **5**
- ↳ Spektori për zbatimin e Instrumentit të Asistencës së Para-Aderimit (IPA) **16**
- ↳ Spektori për zhvillim të qëndrueshëm dhe investime **11**

¹⁹ Informacioni në bazë të kërkesës për qasje në informacionin me karter publik dërguar në MMJPH, mars 2024

- ↳ Sektori i planifikimit hapësinor **9**
- ↳ Sektori Qendra Informative e Maqedonisë për Mjedisin Jetësor **17**
- ↳ Sektori për koordinimin e punës së ministrit **15**
- ↳ Sektori i Çështjeve Financiare **8**
- ↳ Qendra informative hapësinore **3**
- ↳ Drejtoria për Mjedisin Jetësor **1**
- ↳ Sektori Natyrë **15**
- ↳ Sektori i ndotjes industriale dhe menaxhimit të rrezikut **11**
- ↳ Sektori për Ujëra **35**
- ↳ Sektori për Mjedisin Jetësor **18**
- ↳ Sektori i mbetjeve **8**

Numri i të punësuarave është i mjaftueshëm, por është i nevojshëm ristrukturimi i MMJPH-së dhe krijimi i një Agjencie të Mjedisit që do të kryejë punë profesionale, do të mund të kryejë monitorim në të gjitha mediat (ujë, ajër dhe tokë), duke përfshirë monitorimin e specieve, mbikëqyrjen e zonave mbrojtura dhe do të sigurojë zbatim sinkron dhe të përbashkët të politikave të mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe natyrës në nivel kombëtar, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit dhe të dhënave.

